



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli Mbikëqyrës**

**V E N D I M**

**Nr.56, datë 28. 07. 2004**

**PËR MIRATIMIN E**

**“RAPORTIT TË ZHVILLIMEVE EKONOMIKE DHE MONETARE PËR  
GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2004”**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, në bazë të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë *“RAPORTIN E ZHVILLIMEVE EKONOMIKE DHE MONETARE PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2004”*, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun me botimin dhe me dërgimin e këtij raporti në : Kuvendin e Shqipërisë, Presidencë, Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**Ylli Memisha**

**KRYETARI**

**Shkëlqim Cani**

**BANKA E SHQIPËRISË**

**RAPORTI GJASHTËMUJOR I ZHVILLIMEVE EKONOMIKE**

**DHE MONETARE**

**JANAR – QERSHOR 2004**

**KORRIK 2004**

## **PËRMBAJTJA**

I.	Fjala e Guvernatorit .....	3
II.	Zhvillimet ekonomike gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2004.....	7
II.1	Ekonomia Botërore .....	7
II.2	Ekonomia e vendit.....	10
II.2.1	Ecuria e sektorëve të ekonomisë.....	11
II.2.2	Sektori fiskal .....	15
II.2.3	Tregu i punës .....	18
II.2.4	Sektori i jashtëm i ekonomisë.....	19
III.	Inflacioni gjatë periudhës janar - qershor.....	22
III.1	Ecuria e inflacionit dhe e grupeve përbërëse.....	22
III.1.1	Faktorët që kanë ndikuar në ecurinë e inflacionit.....	25
IV.	Zhvillimet monetare dhe tregjet financiare.....	27
IV.1	Politika monetare e Bankës së Shqipërisë .....	27
IV.2	Ecuria e agregatëve monetarë .....	29
IV.3	Kërkesa e brendshme .....	31
IV.3.1	Pozicioni valutor i sistemit bankar.....	31
IV.3.2	Financimi i deficitit buxhetor .....	32
IV.3.3	Kredia për ekonominë.....	33
IV.4	Tregjet financiare dhe ecuria e normave të interesit.....	36
IV.4.1	Zhvillimet kryesore në tregjet financiare .....	36
IV.4.2	Ecuria e normave të interesit.....	37
IV.4.3	Zhvillimet në tregun valutor .....	39
V.	Ecuria e pritshme ekonomike gjatë vitit 2004.....	41

## **I. FJALA E GUVERNATORIT**

Ekonomia botërore gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004 ka vazhduar të ruajë ritmet fundvitit të kaluar, duke regjistruar zhvillime pozitive të treguesve kryesorë. Politikat fiskale nxitëse dhe politikat monetare zbutëse të dy viteve të kaluara kanë dhënë efekte të dukshme në rritjen e ekonomisë amerikane ndërsa ekonomia e vendeve të Eurozonës ka shfaqur ritme disi më të ulëta rritjeje. Monedha amerikane, pas nënçmimit historik në nivelin 1 euro = 1.283 dollarë amerikanë në muajin shkurt, ka vazhduar të luhatet rreth nivelit 1.2, duke u mbështetur kryesisht në të dhënat pozitive të punësimit në muajt në vazhdim.

Ndërkohë që politikat nxitëse në vendet e zhvilluara po rigjallërojnë kërkesën agregate dhe klimën ekonomike, të dhënat paraprake, ndonëse të kufizuara, tregojnë se ekonomia shqiptare ka vazhduar të ruajë ritmet e mëparshme të rritjes, në kufirin rreth 6 për qind. Sigurimi i stabilitetit makroekonomik, përmirësimi i situatës energjitike në vend, niveli relativisht i kënaqshëm i prodhimit bujqësor dhe mbështetja më e mirë e nevojave të ekonomisë për financim nga sistemi bankar, kanë kontribuar në nxitjen e aktivitetit ekonomik për vitin 2004.

Kushtet e favorshme klimaterike gjatë kësaj periudhe, rritja, veçanërisht në sera, e sipërfaqeve të mbjella dhe përmirësimet në teknologjinë e përdorur nga fermerët, mbështesin vlerësimin për një rritje më të lartë se parashikimet të prodhimit bujqësor gjatë vitit 2004. Po kështu, në përputhje me parashikimet për vitin 2004, vlerësohet se rritje paraqesin edhe sektorët e industrisë, të transportit dhe të shërbimeve. Vlerësimet mbi rritjen ekonomike mbështeten edhe nga të dhënat më të fundit të punësimit, sipas të cilave norma e papunësisë në tremujorin e parë të vitit ra në 14.9 për qind. Megjithatë, jo të gjithë sektorët e ekonomisë kanë konfirmuar ritmet e parashikuara të rritjes. Të dhënat e tremujorit të parë tregojnë se sektori i ndërtimit ka patur rënie të theksuar në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo rënie vihet re në numrin e lejeve të ndërtimit, në sipërfaqen dhe fondin e parashikuar për ndërtim, duke lënë shteg për dyshime në lidhje me ecurinë e këtij sektori.

Politika fiskale ka vazhduar të jetë e kujdesshme duke reflektuar një ecuri të kënaqshme brenda kuadrit të programuar. Në fund të muajit qershor deficitit buxhetor rezultoi 8.4 miliardë lekë, duke përbërë rreth 82 për qind të nivelit të parashikuar për këtë periudhë. Kjo ecuri ka reflektuar kryesisht mosrealizimin e

shpenzimeve kapitale të qeverisë në nivelin e parashikuar për këtë periudhë. Gjithësesi, këto shpenzime parashikohet të përshpejtohen gjatë pjesës së mbetur të vitit si pasojë e përdorimit të gjysmës së të ardhurave të privatizimit të Bankës së Kursimeve për financimin e projekteve publike.

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2004 kanë ruajtur pothuajse të pandryshuara tendencat e vërejtura gjatë viteve të fundit. Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të vitit 2004, shënoi nivel pozitiv në masën 15 milionë usd, ndërkohë që zhvillimet në llogarinë korente ende vazhdojnë të flasin për një ekonomi me një bazë ende të vogël prodhuese dhe një shkallë të ulët konkurrence në rajon dhe më gjerë. Tremujori i parë u mbyll me një deficit korent mbi 2 herë më të lartë se tremujori përkatës i vitit paraardhës. Thellimi i deficitit korent ka ardhur si pasojë e rritjes së deficitit tregtar dhe e një përkeqësimi të lehtë të bilancit të shërbimeve, ndërkohë që bilanci i të ardhurave dhe ai i transfertave korente, kanë mbetur pothuajse të pandryshuar.

Presionet inflacioniste gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004 kanë qenë përgjithësisht të kontrolluara. Norma vjetore e inflacionit manifestoi një trend rritës gjatë tre muajve të parë të vitit, duke pasqyruar kryesisht presionet inflacioniste të rritjes së çmimeve të administruara, për t'u stabilizuar më pas brenda intervalit objektiv të Bankës së Shqipërisë prej 2 - 4 për qind gjatë tremujorit të dytë të vitit 2004. Faktorët e kërkesës kanë dhënë një ndikim pozitiv në zhvillimet e inflacionit gjatë kësaj periudhe. Situata e qëndrueshme e likuiditetit, mbajtja nën kontroll e agregatëve monetarë dhe ruajtja e financimit të brendshëm të qeverisë brenda kufirit të lejuar, kanë krijuar një ambient të përshtatshëm monetar për kontrollin e inflacionit. Politika fiskale nga ana e saj ka pasqyruar një ecuri të kontrolluar të shpenzimeve buxhetore duke mos ushtruar presione inflacioniste gjatë këtij gjashtëmujori. Ndikimi i faktorëve të ofertës ka qenë i dykrahshëm. Gjatë tremujorit të parë të vitit, inflacioni është ndikuar negativisht nga faktorët e ofertës, si rritja e çmimit të energjisë, e çmimit të bukës dhe e çmimit të transportit. Korrigjimi në zbritje i tarifave të telefonisë fikse në muajin prill dhe rënia e çmimit të bukës si pasojë e konkurrencës, si dhe hyrja e prodhimit vendas në tregun e brendshëm ndikuan në uljen e normës së inflacionit gjatë tremujorit të dytë të vitit. Gjithashtu, mbiçmimi i lekut ndaj euros dhe dollarit gjatë kësaj periudhe, ka zbutur ndjeshëm efektin e inflacionit të importuar.

Kursi i këmbimit të lekut është mbicmuar përkatësisht me 6.4 për qind dhe 5.4 për qind kundrejt euros dhe dollarit. Në planin afatgjatë, kjo ecuri reflekton konsolidimin e stabilitetit ekonomik në vend dhe rritjen e besimit ndaj monedhës vendase. Ndërkohë, kjo periudhë është karakterizuar edhe nga disa faktorë specifikë, të cilët kanë vepruar të gjithë në kahun e mbiçmimit të lekut. Pa dashur të zgjatem, dëshiroj të përmend se efekti sezonal i futjes së prodhimit bujqësor vendas ka qenë më i shpejtë dhe më i fortë gjatë vitit 2004. Po kështu, fillimi i turizmit më herët se në vitet e mëparshme ka ndikuar në rritjen e ofertës së valutës nga turistët e emigrantët duke ndihmuar në mbiçmimin e lekut. Ndërkohë, kërkesa për lekë ka mbetur e fortë si pasojë e diferencës së normave të interesit midis lekut dhe valutës; diferencë e cila, edhe pse në ulje, ka nxitur interesin e agjentëve ekonomikë për mjete monetare në lekë: depozita dhe bono thesari.

Politika monetare, gjatë gjashtëmujorit të parë, ka vazhduar të jetë në kahun e zbutjes. Qëndrueshmëria e inflacionit brenda objektivit si dhe perspektiva pozitive e tij, kanë bërë të nevojshme përshtatjen e politikës monetare në drejtim të lehtësimit të kushteve monetare në ekonomi. Banka e Shqipërisë ka ulur tre herë normën bazë të interesit brenda periudhës prill-qershor 2004. Duke qenë se çdo ulje e ka çuar normën bazë të interesit në minimume të reja historike, Banka e Shqipërisë ka vepruar me kujdes, duke e ulur atë me 0.25 pikë për qindjeje në çdo rast. Politika e Bankës së Shqipërisë me normën bazë të interesit ka çuar në rënien e normave të interesit në tregjet financiare. Reagimi i bankave të nivelit të dytë ndaj këtyre veprimeve vlerësohet në nivele të kënaqshme. Reduktimi i kostos së parasë do të shërbejë për të nxitur kreditimin në lekë të ekonomisë, për të ulur koston e borxhit të qeverisë dhe për të zbutur presionet mbiçmuese të lekut të vërejtura kohët e fundit.

Kreditimi i ekonomisë gjatë këtij gjashtëmujori, ka ruajtur ritmet e rritjes të vëna re në vitet e fundit. Teprica e kredisë gjatë kësaj periudhe është rritur me 5.5 miliardë lekë, rritje kjo rreth 25 për qind më e lartë se ajo e shënuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Struktura e tepricës së kredisë sipas afateve kohore paraqitet me rritje të tepricës së kredisë afatmesme dhe asaj afatgjatë, pesha e të cilave është rritur në 61.5 për qind të tepricës së kredisë nga 54 për qind që ishte në fund të vitit 2003.

Zhvillimet aktuale në ekonomi dhe pritshmëritë për pjesën e mbetur të vitit 2004, flasin për një periudhë të stabilitetit. Më konkretisht, kjo kornizë makroekonomike nënkupton një ruajtjen e rimit të rritjes ekonomike rreth nivelit 6 për qind për periudhën afatmesme, në kushtet e një norme inflacioni vjetor brenda intervalit

objektiv. Rritja ekonomike do të bëjë të mundur që niveli i deficitit korent, si shprehje relative ndaj prodhimit të përgjithshëm bruto, të qëndrojë pak a shumë në të njëjtat nivele, me ato të vitit të kaluar.

Të dyja politikat bazë si ajo fiskale dhe ajo monetare, do të vazhdojnë të jenë të kujdesshme në përputhje me programin financiar të zhvillimit të vendit. Vlerësohet se të ardhurat e privatizimit të Bankës së Kursimeve kanë krijuar një pozicion më komod për buxhetin e shtetit, ndonëse më shumë kujdes duhet t'i kushtohet realizimit sasior të shpenzimeve kapitale.

Nga ana tjetër, politika monetare do të vazhdojë të ndjekë me kujdes zhvillimet inflacioniste në ekonomi duke i gjykuar ato nga një këndvështrim më i plotë, përfshirë dhe zhvillimet në treguesit e tjerë kryesorë të ekonomisë. Duke gjykuar sa më sipër, Banka e Shqipërisë do të jetë e kujdesshme në vendimmarrjen e saj politike, duke reflektuar muaj pas muaji jo vetëm zhvillimet ekonomike brenda vendit por edhe ato të ndodhura në tregun ndërkombëtar, me objektiv ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

Banka e Shqipërisë do të synojë të ruajë në ekonomi kushtet më të lehta monetare të cilat janë konsistente me ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Kjo politikë nxit zhvillimin e ekonomisë. Ajo synon ruajtjen normave të ulta të interesit, në mbështetje të kreditimit të ekonomisë, dhe ruajtjen e një niveli të pranueshëm të kursit të këmbimit, në mbështetje të qëndrueshmërisë afatgjatë të pozicionit valutor të Shqipërisë. Duke parë në këtë prizëm zhvillimet më të fundit në ekonomi, në vecanti perspektivën pozitive të ecurisë së inflacionit, qëndrueshmërinë e treguesve monetare dhe sjelljen e kursit të këmbimit, Banka e Shqipërisë gjykon të përshtatshme hedhjen e një hapi tjetër në ciklin e zbutjes së politikës monetare. Një ulje e moderuar e normës bazë të interesit do t'i shërbente nxitjes së kreditimit dhe zhvillimit ekonomik, pa cënuar ekuilibrat makroekonomikë të vendit.

# I. ZHVILLIMET EKONOMIKE GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2004.

## I.1 EKONOMIA BOTËRORE

Rritja ekonomike në shkallë botërore filloi të konsolidohej gjatë tremujorit të tretë të vitit të kaluar, duke vazhduar me të njëjtën tendencë edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2004. Politikat nxitëse makroekonomike kanë dhënë pa dyshim ndikimin e tyre në këtë rritje, duke ndikuar në nxitjen e konsumit dhe të investimeve, në përmirësimin e klimës së biznesit, e dëshmuar kjo edhe nga përmirësimi i indekseve të besimit, si dhe në rritjen e tregtisë botërore. Rreziqet gjeopolitike të lidhura me sulmet terroriste kanë ndikuar kryesisht në rritjen e çmimit të naftës, duke u reflektuar edhe në rritjen e presioneve inflacioniste gjatë muajve të fundit, por ato nuk duket se kanë vënë në dyshim qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike.

Tabelë 1. Disa tregues kryesorë të ekonomive botërore (në për qind).

	PBB (tremujori parë)	Papunësia	IÇK	Deficiti buxhetor (% PBB-së)
Britani	3.0	4.7 (shkurt)	+1.5 (maj)	-2.9
Francë	1.7	9.8 (prill)	+2.6 (maj)	-3.8
Gjermani	1.5	10.5 (maj)	+2.0 (maj)	-3.7
Itali	0.8	8.5 (janar)	+2.3 (maj)	-3.1
Japoni	5.6	4.7 (prill)	-0.4 (prill)	-7.1
USA	5.0	5.6 (maj)	+3.1 (maj)	-4.7
Eurozonë	1.3	9.0 (prill)	2.5 (maj)	-2.7

Burimi: Revista "The economist", 26 qershor-2korrik 2004.

Megjithë kahun pozitiv të zhvillimeve të ekonomisë botërore, ritmi i rritjes nuk ka qenë i njëjtë në të gjitha rajonet e botës. Ekonomia amerikane është dalluar për një dinamizëm më të lartë duke shënuar edhe treguesit më të mirë të rritjes ekonomike. Kërkesa e brendshme e lartë, rritja e qëndrueshme e prodhimit industrial dhe rritja e investimeve private në biznes, si pasojë e kushteve të favorshme të financimit, kanë qenë faktorët që kanë përcaktuar rritjen e shpejtë të ekonomisë amerikane. Gjithsesi, kjo rritje nuk ka kuruar problemin e madh që ka ekonomia amerikane me deficitin e llogarisë korente. Në të kundërt, rritja e kërkesës së brendshme dhe deficiti i lartë buxhetor kanë bërë që deficiti tregtar të vazhdojë të rritet. Vlerësohet që për tremujorin e parë të vitit ky deficit do të jetë rreth 14 për qind më i lartë se në të njëjtën periudhë vitin e kaluar, duke përbërë një shqetësim të vazhdueshëm për stabilitetin e treguesve makroekonomikë të ShBA; në veçanti, të kursit të këmbimit të usd.

Në fund të muajit qershor FOMC-ja vendosi rritë, për herë të parë pas katër vjetësh, normën bazë të interesit të usd. Vendimi u mor pasi në ekonominë amerikane ishin shtuar presionet inflacioniste si rrjedhojë e rritjes ekonomike dhe e rritjes së çmimeve të naftës. Rritja e normës bazë ishte modeste, 0.25 pikë për



qindjeje, duke e çuar atë në 1.25 për qind, por ajo pritet të ndiqet nga rritje të tjera gjatë vitit.

Ritmi i rritjes së ekonomisë së Eurozonës ka qenë disi më i ngadaltë. Sipas të dhënave më të fundit vlerësohet se norma e rritjes së PBB-së për tremujorin e parë të vitit në krahasim me të njëjtën periudhë vitin e kaluar është 0.6 për qind. Kërkesa e brendshme e ulët është një prej faktorëve kryesorë që ka ndikuar në këtë ritëm të moderuar rritjeje. Rritja e ekonomisë së Eurozonës gjatë pjesës së parë të vitit është mbështetur kryesisht në kërkesën e jashtme dhe eksportet.

**Box 1. Zgjerimi i Bashkimit Evropian.**

Në 1 maj 2004, Bashkimit Evropian iu shtuan edhe 10 shtete të tjera: Qipro; Republika Çeke; Estonia; Hungaria; Latvia; Lituania; Malta; Polonia; Sllovakia dhe Slovenia, duke e çuar në 25 numrin e vendeve anëtare të këtij bashkimi. Ky është zgjerimi më i madh përsa i përket numrit të vendeve por jo në aspektin e peshës ekonomike. Numri total i popullsisë u rrit me rreth 20 për qind ndërsa PBB-ja u rrit me 5 për qind.

Disa tregues të ekonomisë së Bashkimit Evropian, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Japonisë.

		Njësia	BE 15	BE 25	USA	Japoni
Popullsia	2004	Mln	380.8	454.9	291.4	127.7
PBB (% e PBB-së botërore)	2002	%	26.8	28.1	32.5	12.3
PBB	2002	Euro-	9.172	9.615	10.980	4.235
PBB për frymë	2002	Euro mijë	24.0	21.1	37.7	33.2
Eksporte	2002	% PBB	10.9	9.5	6.5	9.9
Importe	2002	% PBB	10.8	9.8	11.1	7.6
Norma e papunësisë	2003	%	8.0	9.0	6.0	5.3
Deficiti buxhetor	2002	% PBB	-2.0	-2.1	-3.4	-6.1

**Burimi: Raporti mujor i Bankës Qendrore Evropiane, Maj 2004.**

Zgjerimi i Bashkimit Evropian nënkupton edhe zgjerim të Tregut të Përbashkët Evropian, duke sjellë rritjen e konkurrencës në të. Në kushtet e ekonomive të shkallës dhe të rritjes së konkurrencës, pritet këtë çmime më të ulëta dhe produktivitet më të lartë, duke ndikuar në rritjen ekonomike. Hyrja e vendeve të reja ka sjellë ndryshimin e peshave të sektorëve të ekonomisë. Kështu, pesha që zë sektori i bujqësisë në strukturën e prodhimit të vendeve të reja anëtare është më e madhe në krahasim me peshën që këta sektorë zënë në strukturën e prodhimit të BE-së.

Në periudhën afatgjatë, bashkimi do të kontribuojë në rritjen e ekonomisë dhe të mirëqënies së bashkimit evropian, pasi do të shërbejë për rritjen e "katër lirive" - lëvizjes së lirë të mallrave, të shërbimeve, të kapitalit dhe të punës. Ritmi që do të zhvillohet kjo bashkësi e madhe do të varet nga harmonizimi i politikave të reja dhe të vjetra si dhe nga reformat strukturore të cilat duhen ndërmarrë me qëllim rritjen e fleksibilitetit të tregut të përbashkët.


Pavarësisht mbivlerësimit të euros, eksportet e Eurozonës vazhdojnë të rriten dhe llogaria korente vazhdon të shënojë suficit që prej muajit qershor të vitit

2003. Ndërkohë, gjendja e dobët e ekonomisë ka bërë që ecuria e financave publike të shënojë përkeqësim. Norma mesatare e deficitit buxhetor ndaj PBB-së vazhdon të jetë në nivelin 2.7 për qind. Madje, gjashtë vende – Gjermania, Greqia, Franca, Italia, Holanda dhe Portugalia – e kanë këtë normë mbi nivelin 3 për qind të lejuar sipas Traktatit të Mاستrihit. Ky tejkalim i redukton mjaft hapësirat e tyre për një politikë fiskale rritëse.

### Kursi ndërkombëtar i këmbimit.

Gjatë pjesës së parë të vitit 2004, euro ka vazhduar të vlerësohet në terma nominalë efektivë, duke reflektuar vlerësimin kundrejt gjithë monedhave të tjera. Në fillim të vitit 1 euro shkëmbehej me 1.26 dollarë duke arritur pikun e këtij gjashtëmujori në 17 shkurt ku një euro u shkëmbye me 1.2833 dollarë. Sinjalet pozitive që erdhën nga ekonomia amerikane gjatë muajit maj, në mënyrë të veçantë në lidhje me kushtet e mira të tregjeve të punës bënë që dollari të fitonte pikë duke arritur nivelin më të ulët të kësaj periudhe ku një euro u këmbye me 1.181 dollarë. Të dhënat mbi thellimin e deficitit të llogarisë korente amerikane që erdhën në mesin e dytë të muajit maj, bënë që euro të rifitonte të gjitha pikët e humbura.

Grafik 1. Ecuria e kursit nominal efektiv të euros dhe dollarit amerikan dhe kursi spot i këmbimit euro/usd për periudhën janar 2003 - qershor 2004.



Burimi: Bloomberg.

Në datën 27 qershor sipas procedurave dhe marrëveshjeve reciproke u vendos që të përfshiheshin në ERM II<sup>1</sup> monedhat e Estonisë, të Lituanisë dhe të Sllovenisë.


### Çmimet e naftës.

Çmimet e naftës janë rritur në mënyrë të ndjeshme gjatë pjesës së parë të vitit duke shkaktuar shqetësime për të gjitha ekonomitë e vendeve importuese, pasi kanë rritur nivelin e inflacionit në këto vende si dhe kanë ndikuar negativisht në

<sup>1</sup> ERM II është faza paraprake e adoptimit të monedhës Euro.

ekonomi. Në rritjen e çmimit të naftës ka ndikuar rritja e madhe e kërkesës për naftë dhe situata e rënduar në Lindjen e Mesme. Vlerësohet se aktualisht kërkesa për naftë është në nivelet më të larta të 16 viteve të fundit. Zhvillimi i ekonomisë amerikane dhe ekspansioni i ekonomisë kineze ka rritur në mënyrë të ndjeshme kërkesën për naftë. Në të njëjtën kohë kompanitë e naftës përipiqen të jenë më eficiente duke ulur nivelin e stoqeve me të cilat operojnë në tregje. Në këtë mënyrë në tregje ka më pak rezerva në raste ndërprerjesh të prodhimit.

Grafik 2. Ecuria e çmimeve të naftës së papërpunuar, janar 2003 - qershor 2004.



Burimi: Bloomberg.

Në datën 3 qershor, në takimin e ministrave të OPEC-ut në Bejrut, u ra dakord që të rriteshin kuotat e prodhimit të naftës. Ky vendim u reflektua menjëherë në rënien e çmimit të naftës si në tregun amerikan ashtu edhe në tregun anglez (Brent crude).

## 1.2 EKONOMIA E VENDIT.

Politikat ekonomike stabilizuese, zhvillimi dinamik i sektorit privat dhe një periudhë relativisht e qetë politike kanë bërë që ekonomia të shënojë rritje të shpejtë gjatë viteve të fundit. Ekonomia shqiptare është rritur mesatarisht me 6.1 për qind gjatë tre viteve të shkuara dhe parashikohet të rritet me rreth 6 për qind gjatë vitit 2004. Viti 2004 paraqet në tërësi një situatë të favorshme për zhvillimin ekonomik. Duke u bazuar në stabilitetin makroekonomik, reduktimi i problemeve energjitike, prodhimi i kënaqshëm bujqësor dhe mbështetja më e mirë e nevojave të ekonomisë për financim nga sistemi bankar do të kontribuojnë në nxitjen e aktivitetit ekonomik. Gjithashtu, përdorimi i një pjese të të ardhurave të privatizimit të Bankës së Kursimeve për financimin e projekteve publike do t'i japë ekonomisë një impuls zhvillimi për vitin 2004, duke krijuar njëkohësisht një infrastrukturë më të mirë për rritjen ekonomike në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Tabelë 2. Rritja reale e PBB-së.

	2002	2003	2004*
Ekonomia	4.7	6.0	6.2
- Industria	1.8	2.7	3.1
- Bujqësia	2.1	3.0	3.0
- Ndërtimi	8.7	11.3	10.6
-Transporti	9.7	10.8	10.1
-Shërbimet	5.1	6.4	6.4

\* 2004 parashikim.

Burimi: Ministria e Financave.

Analiza e treguesve ekonomikë që disponon Banka e Shqipërisë tregon se ekonomia shqiptare, megjithë disa dobësi të vërejtura në sektorë të veçantë, mund të përmbushë objektivin e rritjes ekonomike prej rreth 6 për qind të parashikuar për vitin 2004. Kërkesa e brendshme, në përgjithësi ka shfaqur tendenca rritëse. Kështu, në tremujorin e parë të këtij viti importi i automjeteve, i televizorëve dhe i makinave larëse është rritur me 24 për qind, 89 për qind dhe 48 për qind respektivisht në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Konsumi i dukshëm i karburanteve është 9 për qind më i ulët se tremujori i parë i vitit 2003 dhe 29 për qind më i ulët se tremujori i fundit i vitit të kaluar. Në veçanti, sektori i bujqësisë, sektori i industrisë dhe ai i transporteve paraqiten me tregues mjaft të përmirësuar në krahasim me vitin e kaluar në një kohë që sektori i ndërtimit ka shënuar një përkeqësim. Gjithashtu, investimet e huaja ishin 35 milionë dollarë për tremujorin e parë të këtij viti, duke regjistruar një rënie prej 8 për qindësh nga tremujori i parë i vitit të kaluar.

### I.2.1 ECURIA E SEKTORËVE TË EKONOMISË.

#### BUJQËSIA

Të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit konfirmojnë një ecuri të mirë të prodhimit bujqësor gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Kushtet e favorshme klimaterike gjatë kësaj periudhe, rritja e sipërfaqeve të mbjella dhe veçanërisht rritja me rreth 12 për qind e sipërfaqes së shfrytëzuar për sera, si dhe përmirësimet në teknologjinë e përdorur nga fermerët mbështesin vlerësimin që prodhimi bujqësor gjatë vitit 2004 është rritur sipas parashikimeve, në të gjithë sektorët e saj.

Tabelë 3. Parashikimi i prodhimit bujqësor sipas sektorëve për vitin 2004.

	Rritja (në %)	Vlera (në miliardë lekë)
Bujqësi	3.0	194.7
Agroindustri	10.0	41.5
Peshkimi	4.0	2.4
<b>Totali</b>	<b>4.0</b>	<b>238.6</b>

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Prodhimi agroindustrial për tremujorin e parë të vitit 2004 vlerësohet të jetë 6.3 miliardë lekë, duke u rritur me 20.4 për qind në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2003. Eksperienca e viteve të kaluara sugjeron se përpunimi i produkteve bujqësore arrin pikun e tij gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit.

Tabelë 4. Ecuria e prodhimit industrial gjatë tremujorit të parë për vitet 2002-2004

<b>T1 2002</b> (milionë lekë)	<b>T1 2003</b> (milionë lekë)	<b>T1 03/T1 02</b> (në %)	<b>T1 2004</b> (milionë lekë)	<b>T1 04/T1 03</b> (në %)
4.9	5.3	7.7	6.3	20.4

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Megjithëse mungojnë të dhënat për të mbuluar të gjithë harkun gjashtëmujor, realizimi i prodhimit agroindustrial gjatë tre muajve të parë të këtij vitit përmban shenja optimiste për realizimin e parashikimit të fillimvitit për prodhimin në këtë degë.

Tabelë 5. Parashikimi i ecurisë së prodhimit bujqësor e blegtoral për vitin 2004.

	<b>Rritja (në %)</b>	<b>Vlera (në miliardë lekë)</b>
Bimët e arave	0.5	83.8
Pemëtaria	5.9	20.3
Blegtoria	4.3	90.6
<b>Totali</b>	<b>3.0</b>	<b>194.7</b>

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.


Investimet e mbuluara me fonde të huaja janë realizuar në masën 30 për qind gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Pjesa tjetër e projekteve me financim të huaj pritet të fillojnë zbatimin në muajt që vijojnë. Disa nga projektet më të rëndësishme kanë qenë projekti për rehabilitimin e sistemit të ujitjes dhe të kullimit (është për të theksuar se këtë vit treguesit e ujitjes janë më të mira se vitet e mëparshëm), projekti i shërbimeve bujqësore, projekti i peshkimit, projekti i regjistrimit të pasurive të paluajtshme, projekti i rritjes së prodhimit ushqimor dhe programi i zhvillimit të zonave malore.

## **INDUSTRIA**

Edhe sektori i industrisë karakterizohet nga tregues pozitivë gjatë gjashtëmujorit të parë. Prodhimi mall i shitur është rritur në masën 25.9 për qind gjatë pesë muajve të parë të vitit, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të shkuar.

Rritja më lartë, në masën 43.5 për qind, është shënuar në sektorin e energjitikës. Gjithashtu, industria kimike dhe ajo e përpunimit të drurit dhe të letrës janë rritur në masën 16.5 dhe 3.3 për qind respektivisht krahasuar me një vit më parë. Prodhimi i karburanteve në këtë pesëmujor ka patur një rritje prej 22.4 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritja e çmimit në tregun ndërkombëtar ka nxitur prodhimin në vend si dhe hedhjen në treg të një pjese të rezervave të naftës.

Grafik 3. Ecuria e shitjeve të disa sektorëve të industrisë (në miliardë lekë).




Burim: INSTAT.

### ENERGJIA

Prodhimi i energjisë elektrike shënoi një rritje me rreth 3.51 për qind në pesëmuajorin e parë të vitit 2004. Rritja e prodhimit të brendshëm ka ulur nevojën për të importuar energji gjatë kësaj periudhe. Importi i energjisë elektrike pati një rënie prej 15.6 për qind në pesë muajt e parë të këtij viti. Hidrocentralet mbeten prodhuesit më të mëdhej në vend, duke mbuluar rreth 98.8 për qind të prodhimit gjithsej, ndërkohë që pesha e termocentraleve vazhdon të jetë në rënie duke regjistruar nivelin më ulët të prodhimit, krahasuar me vitin 2003.

Nga ana tjetër, eksporti ka rënë në masën 22 për qind. Kjo ka bërë që përdorimi i energjisë në vend të rritet me 3.5 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Grafik 4. Bilanci i energjise e lektrike (në MVVh).



Burimi: INSTAT.

### NDËRTIMI

Sektori i ndërtimit pritet të japë një kontribut të rëndësishëm në ekonominë shqiptare edhe gjatë vitit 2004. Për këtë vit, ky sektor pritet të rritet me rreth 10.6 për qind, duke dhënë 9.5 për qind të vlerës së shtuar totale të ekonomisë.

Të dhënat e tremujorit të parë tregojnë se ky sektor ka patur rënie të theksuar në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke lënë shteg për dyshime në lidhje me ecurinë e këtyre parashikimeve. Ecuria e dobët e sektorit vihet re në parametrat kryesorë të matjes së ecurisë të këtij sektori; lejet e ndërtimit, sipërfaqja dhe fondi i parashikuar për ndërtime. Kjo situatë paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabelë 6. Parametrat kryesorë të sektorit të ndërtimit.

	T1 '03	T1 '04
Leje ndërtimi	757	68
Sipërfaqe ndërtimi (mijë m <sup>2</sup> )	445.7	154
Fond i parashikuar për ndërtim (miliardë lekë)	21.3	4.3

Në të njëjtën kohë, Indeksi i Kushtimit në Ndërtim shënoi një rritje prej 3.94 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Shpenzimet direkte u rritën me 0.39 për qind në krahasim me tremujorin e kaluar dhe 5.51 për qind në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2003. Shpenzimet materiale gjithashtu, u rritën me 6.07 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2003.


Për momentin, këta tregues nuk përbëjnë argument të mjaftueshëm për të vënë në dyshim realizimin e rritjes së parashikuar vjetore të sektorit, duke ditur karakterin sezonal të tij dhe përqendrimin e punimeve në pjesën tjetër të vitit. Gjithsesi, këta tregues nënvizojnë nevojën e një kujdesi më të madh në lidhje me ecurinë e këtij sektori vital të ekonomisë.

## TRANSPORTI

Vëllimi i punës së ngarkim-shkarkimit gjatë pesëmuajorit të parë të vitit 2004 u rrit me 15 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë duke arritur në 1.55 milionë ton. Ndër sektorët që patën rritje më të lartë janë shërbimi hekurudhor dhe portet detare, të cilat u rritën me 22 dhe 14.4 për qind respektivisht. Vëllimi i punës së ngarkim- shkarkimit në porte, zë rreth 91 për qind të totalit të përgjithshëm të këtij vëllimi. Rritja e vëllimit të punës së ngarkim – shkarkimit, sidomos në porte, vjen si pasojë e përmirësimit të kushteve dhe infrastrukturës, furnizimit më të mirë me energji elektrike, si dhe rritjes së vëllimit të tregtisë së jashtme.

Investimet gjithsej, në sektorin e transportit janë ulur në masën 5.9 për qind në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2003. Edhe pse investimet e brendshme buxhetore u rritën në masën 51.6 për qind, investimet e huaja në këtë sektor u ulën në 47.8 për qind.

Grafik 5. Investimet dhe burimet e tyre në sektorin e transportit.




Burim: Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve.

Për sa i përket transportit ajror, është shënuar një rritje prej 10 për qind e numrit të pasagjereve dhe një rritje prej 13.6 për qind e numrit të avioneve dhe mbikalimeve, ndërkohë që u pa një ulje prej 27.1 për qind e mallrave dhe postës.

### 1.2.2 SEKTORI FISKAL

Në përgjithësi, politika fiskale dhe treguesit fiskalë kanë ecur brenda kuadrit të programuar për këtë periudhë. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, deri në fund të muajit maj, janë mbledhur 93 për qind e të ardhurave të planifikuara dhe është realizuar rreth 91 për qind e shpenzimeve të programuara. Kjo ka bërë që deficitin buxhetor, në fund të muajit maj, të jetë rreth 5.9 miliardë nga 7.9 miliardë lekë të parashikuara. Financimi i brendshëm i deficitit arriti në 3.2 miliardë lekë përkundërt nivelit prej 3.4 miliardë lekësh të parashikuar, ndërsa financimi i huaj i deficitit arriti në 2.7 miliardë lekë ose 62 për qind e vlerës së parashikuar.

Grafik 6. Treguesit fiskalë, janar '98 – maj '04 (në milionë lekë).



Burimi: Ministria e Financave.



Tabelë 7. Treguesit fiskalë (në miliardë lekë).


	Janar – Maj 2004	Ndryshimi në % me të njëjtën periudhë në 2003	Realizimi i planit (%)
Të ardhurat	25.7	9.2	92.6
Shpenzimet	33.8	6.6	91
Deficiti	8,1	-16.2	75.3

Burimi: Ministria e Financave.

### TË ARDHURAT BUXHETORE

Gjatë muajve janar–maj të këtij viti, të ardhurat buxhetore ishin rreth 9.2 për qind më të larta krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2003. Niveli i të ardhurave tatimore, në fund të muajit maj, arriti në rreth 64.3 miliardë lekë, ndërsa tatimet e mbledhura nga doganat rezultuan rreth 5.1 miliardë lekë, duke realizuar nivelin e parashikuar në projektbuxhetin e fillimvitit me 97 për qind dhe 95 për qind respektivisht.

Grafik 7. Struktura e të ardhurave buxhetore.



Burimi: Ministria e Financave.

Tatimet mbeten burimi kryesor i të ardhurave buxhetore. Ato deri në muajin maj përbëjnë 71.3 të të ardhurave totale. Ndryshe nga periudhat e mëparshme, tatimi mbi vlerën e shtuar tejkaloi nivelin e parashikuar duke u realizuar në masën 103 për qind. Gjithashtu, vihet re se të ardhurat nga pushteti lokal vazhdojnë të tejkalojnë planin duke u realizuar në masën 101.76 për qind.

Tabelë 8. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat. (në miliardë lekë).


	Mars	Maj	Plani	%	Plani vjetor	%
<b>Tatimet dhe Doganat</b>	26.6	46.2	47.7	<b>97</b>	125.6	<b>37</b>
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	12.5	21.6	21.0	103	57.1	38
Tatimi mbi fitimin	3.6	6.1	6.3	96	15.2	40
Akcizat	2.9	5.5	6.0	91	16.2	34
Tatimi mbi të ardhurat personale	1.6	2.6	3.0	87	8.2	32
Taksa nacionale dhe të tjera	2.8	4.4	5.2	85	12.6	35
Taksa doganore	3.0	5.1	5.4	95	14.7	35

Burimi: Ministria e Financave.

### SHPENZIMET BUXHETORE

Shpenzimet buxhetore gjatë pesë muajve të parë të vitit ishin 76.9 miliardë lekë, duke përbërë rreth 91 për qind të nivelit të programuar për këtë periudhë. Shpenzimet e personelit u realizuan në masën 101 për qind ndërkohë që shpenzimet kapitale vazhdojnë të realizohen më pak se ishte planifikuar duke arritur masën 68 për qind. Nga këto të fundit, shpenzimet e mbuluara me financim të huaj u realizuan në masën 52 për qind. Ecuria e shpenzimeve kapitale pritet të ketë rritje të ndjeshme në muajt e ardhëm si pasojë e vendimit qeveritar për të përdorur një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i Bankës së Kursimeve për investime strategjike.


Grafik 8. Struktura e shpenzimeve buxhetore (në milionë lekë).



Burimi: Ministria e Financave.

Shpenzimet korente përbëjnë (për periudhën janar – maj 2004) 87.6 për qind të shpenzimeve totale, duke marrë kështu përparësi në procesin e vendimmarrjes qeveritare.

Grafik 9. Përbërja e shpenzimeve korente (në milionë lekë).




Burimi: Ministria e Financave.

### DEFICITI FISKAL

Deficiti fiskal, për pesë muajt e parë të vitit, është afërsisht 75 për qind e nivelit të planifikuar. Mbajtja nën kontroll e shpenzimeve ka ndikuar në kontrollin e deficitit fiskal.

Grafik 10. Financimi i deficitit buxhetor për vitin 2004.



Burimi: Ministria e Financave.

### I.2.3 TREGU I PUNËS

Tregu i punës gjatë pjesës së parë të vitit 2004 u karakterizua nga rënia e theksuar e numrit të forcave të punës dhe të të punësuarve. Forcat e punës shënuan një rënie me rreth 11 mijë vetë, kryesisht si rezultat i rënies së numrit të të punësuarve me 8 mijë vetë. Rënia prej 3 mijë vetësh e punësimit në sektorin shtetëror ka patur si arsye vazhdimin e reformës në administratën shtetërore dhe në mënyrë të veçantë në ndërmarrjet e mëdha, ende të paprivatizuara shtetërore. Nga ana tjetër, kemi një rënie me 5 mijë vetësh të punësimit në sektorin privat jo bujqësor. Tremujori i parë i vitit zakonisht nuk dallohet për rritje të këtyre treguesve të punës. Megjithatë, ulja në treguesit e punësimit mendohet se është e lidhur me periudhën kur janë kryer matjet në lidhje me këtë tregues. Kështu, gjatë periudhës janar-mars subjektet private kryejnë regjistrimin e bizneseve të tyre dhe statistikat mund të shfaqen të deformuara dhe jo realiste, për faktin se koha nuk është e mjaftueshme për t'i mbledhur ato. Jo rastësisht vlera prej 5 mijë vetësh i përket rrethit të Tiranës, ku dhe janë përqëndruar pjesa më e madhe e industrive dhe shërbimeve. Për këtë shkak, të dhënat e punësimit në këtë sektor duhet të merren me rezerva. Një tablo më e qartë do të merret pasi të publikohen të dhënat e tremujorit të dytë të këtij viti. Sinjalet tregojnë se ky tregues është me rritje për këtë tremujor. Ky gabim në matje nuk përjashton mundësinë që forcat e punës janë ulur gjatë këtij tremujori, si pasojë e fenomenit të emigracionit apo të tregut të zi.

Tabelë 9. Treguesit e tregut të punës (në mijë vetë).


	2002				2003				2004
	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV	Tr.I
Forcat e punës gjithsej (në mijë)	1096	1093	1094	1094	1096	1093	1092	1091	1080
<b>A. Të punësuar gjithsej (në mijë)</b>	918	917	919	921	926	927	928	927	919
i) në sektorin shtetëror	189	188	187	187	185	185	184	182	179
ii) në sektorin privat jo bujqësor	6	203	206	208	207	208	210	211	206
iii) në sektorin privat bujqësor	526	526	526	526	534	534	534	534	534
<b>B. Papunësia (në mijë)</b>									

i) të papunë gjithsej	178	176	175	173	170	166	164	164	161
ii) Përfitojnë pagesë papunësie	13	13	12	11	11	11	11	11	11.7
C. Shkalla e papunësisë (në %)	16.2	16.1	16.0	15.8	15.5	15.2	15.0	15.0	14.9

Burimi: Instat, Koniuktura qershor, 2003.

Treguesit e papunësisë vazhdojnë të jenë pozitivë edhe në këtë tremujor. Numri i të papunëve ka rënë me tre mijë vetë duke e çuar normën e papunësisë në 14.9 për qind.

Grafik 11. Numri i të papunëve në tre vitet e fundit ( në mijë vetë).



## I.2.4 SEKTORI I JASHTËM I EKONOMISË

Zhvillimi i ekonomisë gjatë gjysmës së parë të vitit është shoqëruar me një forcim të mëtjshëm të pozicionit të jashtëm të saj. Bilanci i pagesave për tremujorin e parë të vitit 2004 ishte pozitiv. Ai shënoi 15 milionë usd, shumë kjo e barabartë me rritjen e rezervave valutore të autoritetit monetar. Tremujori i parë u mbyll me një deficit korent mbi 2 herë më të lartë se tremujori i parë i vitit paraardhës. Thellimi i deficitit korent ka ardhur si pasojë e rritjes së deficitit tregtar dhe e një përkeqësimi të lehtë të bilancit të shërbimeve, ndërkohë që bilanci i të ardhurave dhe ai i transfertave korente, kanë mbetur pothuajse të pandryshuar. Ky tremujor ka shënuar rënie të transfertave kapitale dhe të investimeve të huaja. Flukset hyrëse në llogarinë kapitale dhe financiare kanë financuar rreth 80 për qind të deficitit korent. Megjithëse mungojnë të dhëna të plota për tremujorin e dytë, rezerva valutore ka vijuar të rritet edhe gjatë kësaj periudhe, duke sugjeruar një ecure rezultante pozitive të bilancit të pagesave.

Tabelë 10. Llogaritë e bilancit të pagesave (në milionë usd).

	T1-2004	T1-2003	T1-04/T1-03 (%)
A. Llogaria korente	-74.2	-32.3	130
A.1. Bilanci tregtar	-314.8	-285.5	10
A.1.1. Importet e mallrave	-451.3	-394	15
A.1.2 Eksportet e mallrave	136.5	108.5	26
A.2. Bilanci i shërbimeve	-6.0	4.1	
A.3. Bilanci i të ardhurave	36.3	38.9	-7
A.4. Transfertat korente	209.9	210.2	0

B. Llogaria kapitale (neto)	34.0	31.0	10
C. Llogaria financiare (neto)	25.1	55.5	-55
C.1 Rritja në detyrime	87.6	67.0	31
C.2.Rritja në mjete	-62.5	-11.5	443
D. Rritja në mjetet e rezervës	-14.9	-57.0	-74
E. Gabimet dhe harresat neto	30.3	2.8	982


### Llogaria korente

Gjatë tremujorit të parë të vitit transaksionet korente të Shqipërisë me botën kanë kapur masën 1.3 miliardë usd (600 milionë usd eksporte dhe 676 milionë usd importe). Peshën kryesore në transaksionet korente (46 për qind) e mbajnë transaksionet tregtare në mallra. Llogaria që ka balançuar deficitin tregtar, ashtu si në shumë tremujorë paraardhës, ka qenë ajo e transfertave korente. Llogaria e shërbimeve, pavarësisht nga vëllimi i konsiderueshëm i hyrjeve (rreth 1.4 herë më të larta se eksportet e mallrave) dhe i daljeve (afërsisht 45 për qind e importeve në mallra), nuk ka luajtur ndonjë rol të rëndësishëm në ecurinë e llogarisë korente, për shkak të bilancit të vogël.

### Tregtia e jashtme.

Vëllimi i përgjithshëm tregtar gjatë tremujorit të parë ishte 590 milionë usd ose rreth 85 milionë dollarë më i lartë se ai i të njëjtës periudhë për vitin 2003. Rritja e eksporteve me një ritëm më të lartë se ai i importeve, nuk ka rezultuar në ngushtim të deficitit tregtar. Ky i fundit për tremujorin ka qenë 315 milionë usd ose 10 për qind më i lartë se ai i tremujorit të parë të vitit 2003. Megjithatë, duhet vlerësuar fakti që eksportet e mallrave për këtë tremujor, kanë shënuar nivelin më të lartë të eksporteve për tremujor në vite. Në kahun e importeve, është vërejtur rritje e vazhduar e importeve në mallra kapitale, si dhe në mallra për përpunim aktiv. Gjithashtu e lartë mbetet kërkesa për mallra ushqimorë. Kontributin kryesor në rritjen e eksporteve shqiptare e kanë dhënë riekportet, të cilat dominojnë eksportet shqiptare, duke zënë aktualisht 81 për qind të vëllimit të përgjithshëm të tyre. Riekportet janë rritur me 32 për qind ndaj tremujorit të parë të vitit të kaluar, ndërkohë që eksporti nga prodhimi i brendshëm ka shfaqur ecuri të ngadaltë. Shkalla e përfaqësimit të tij në eksportin total vlerësohet në 19 për qind.

Grafik 12. Bilanci i tregtisë së jashtme (në milionë usd).



### **Shërbimet, të ardhurat dhe transfertat korente**

Deficiti prej 6 milionë usd në bilancin e shërbimeve, ka ardhur si pasojë e thellimit të deficitit në shërbimet e transportit dhe e ngushtimit të suficitit në shërbimet e udhëtimit. Importet e shërbimeve u vlerësuan në 197 milionë usd, ndërsa eksportet 203 milionë usd. Peshën më të madhe, në të dyja kahet, e mbajnë shërbimet e turizmit dhe ato të transportit (79 për qind e hyrje dhe 82 për qind e daljeve). Eksporti i shërbimeve është 45 për qind më i lartë se ai i mallrave.

Kategoria e të ardhurave për tremujorin e parë u mbyll me një bilanc pozitiv të përafërt me atë të tremujorit të parë të vitit të kaluar (36 milionë usd). Të ardhurat nga puna (22 milionë usd) në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar kanë mbetur të pandryshuara. Të ardhurat nga investimet e portofolit (8 milionë usd) dhe nga investimet e rezervës (10.5 milionë usd) kanë regjistruar një rritje të lehtë në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar.

Llogaria e transfertave korente e mbylli tremujorin me një bilanc pozitiv prej 210 milionë dollarësh, pa shënuar ndonjë ndryshim të dukshëm në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2003. Peshën kryesore (rreth 85 për qind) të të ardhurave në këtë kategori vazhdojnë ta zënë transfertat e emigrantëve shqiptarë me banim jashtë. Gjatë kësaj periudhe, këto transfertat janë vlerësuar 194 milionë usd. Bilanci pozitiv i transfertave korente ka mbuluar 72 për qind të deficitit në mallra dhe shërbime për tremujorin e parë të vitit.

### **Llogaria kapitale dhe financiare dhe mjetet e rezervës**

Gjatë tre muajve të parë të vitit, flukset neto hyrëse në llogarinë kapitale dhe financiare janë vlerësuar rreth 59 milionë usd. Nga këto hyrje, 34 milionë usd kanë qenë hyrje në llogarinë kapitale ndërsa 25 milionë usd, hyrje neto në llogarinë financiare. Kjo e fundit ka shënuar rritje si në anën e detyrimeve, ashtu edhe në atë të pretendimeve ndaj jorezidentëve. Rreth 40 për qind e rritjes së detyrimeve tona financiare, këtë tremujor, ka ardhur prej fluksit të investimeve të huaja direkte, të cilat kapën shifrën 35 milionë usd, duke shënuar rënie të lehtë ndaj tremujorit të parë të vitit të kaluar. Detyrimet e rezidentëve janë rritur, gjithashtu, si pasojë e rritjes së borxhit të jashtëm zyrtar (me 27.5 milionë dollarë) dhe e rritjes së depozitave të jorezidentëve në vend (me 10 milionë dollarë). Nga ana tjetër, pretendimet e rezidentëve ndaj jorezidentëve gjatë tremujorit janë rritur me 62.5 milionë dollarë. Rritja e mjeteve është përcaktuar kryesisht nga lëvizjet në depozitat e njësive rezidente jashtë (rritje me 41 milionë dollarë) si edhe nga rritja neto në mjetet e tjera. Rezervat e autoritetit monetar gjatë tremujorit të parë të vitit u rritën me rreth 15 milionë usd, rritje që erdhi pjesërisht nga rritja në mjetet valutore dhe pjesërisht nga rritja në zotërimet në Sdr. Stoku i rezervave vlerësohet në 1028 milionë usd dhe mbulon 4.7 muaj importe të mallrave dhe shërbimeve.

## II. INFLACIONI GJATË PERIUDHËS JANAR - QERSHOR.

### I.3 ECURIA E INFLACIONIT DHE E GRUPEVE PËRBËRËSE.

Presionet inflacioniste gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004 kanë qenë përgjithësisht të kontrolluara. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë dhe faktorët e tjerë të përhershëm që ndikojnë në ecurinë e çmimeve kanë zbutur efektin negativ të rritjes së disa çmimeve të administruara. Ky efekt balancues ka bërë që inflacioni vjetor, me përjashtim të muajit shkurt, të luhatet brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë.


Gjatë tre muajve të parë të këtij viti, norma vjetore e inflacionit manifestoi një trend rritës, duke pasqyruar presionet inflacioniste të rritjes së çmimeve të energjisë, bukës dhe transportit, si dhe rritjen e tarifave të telefonisë fikse në muajin dhjetor 2003. Stabilizimi i normës vjetore të inflacionit brenda intervalit objektiv të Bankës së Shqipërisë prej 2 – 4 për qind, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2004, rezultoi nga bashkëveprimi pozitiv i faktorëve të kërkesës, përfshirë dhe ata monetarë dhe faktorëve të ofertës, kryesisht rishikimi i tarifave të telefonisë fikse dhe i çmimit të bukës, si dhe efekti rënës i hyrjes së prodhimit bujqësor vendas.

Tabelë 11. Norma vjetore e inflacionit (në për qind).

	2000	2001	2002	2003	2004
Janar	-1.3	2.2	6.5	0.0	3.3
Shkurt	-1.3	1.5	7.6	1.1	4.4
Mars	-2.1	2.9	7.5	1.3	4.0
Prill	-1.4	3.0	6.5	2.3	3.2
Maj	-0.1	2.5	4.6	2.8	2.6
Qershor	0.1	4.0	3.7	2.6	2.9
Korrik	-1.3	5.6	4.2	3.0	
Gusht	-0.7	4.1	5.5	3.0	
Shtator	0.9	3.5	5.3	2.8	
Tetor	1.8	1.8	5.8	2.9	
Nëntor	1.9	2.8	3.7	3.4	
Dhjetor	4.2	3.5	1.7	3.3	
Mesatar	0.05	3.13	5.22	2.37	

Rritja e inflacionit në tremujorin e parë u diktua nga rritja e çmimit të energjisë elektrike me 31.2 për qind në muajin janar 2004. Krahas efektit të rritjes së çmimit të energjisë, inflacioni në muajin prill pasqyroi dhe rritjen e çmimit të qirasë me 3.5 pikë për qindjeje. Për pasojë, grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse” shënoi normën më të lartë të inflacionit prej 11.0 për qind, në muajin prill.

Grafik 13. Inflacioni vjetor (në për qind).




Kontributi i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse” në inflacionin total erdhi në rënie gjatë muajve maj – qershor, si rezultat i rënies me 7.9 pikë për qindje të inflacionit të çmimit të gazit.

Tabelë 12. Norma mujore dhe vjetore e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji”.

	"Qira, ujë, lëndë djegëse, energji"		"Qira"		"Lëndë djegëse dhe energji"	
	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore	Mujore	Vjetore
Janar '04	0.0	3.7	0.0	2.6	0.3	6.9
Shkur'04	4.9	8.5	-0.5	2.1	26.4	35.0
Mars'04	0.0	8.3	0.0	2.1	-0.1	35.0
Prill '04	2.4	11.0	3.5	5.6	0.1	35.1
Maj' 04	0.0	9.7	0.0	5.6	0.0	27.2
Qershor'04	0.0	9.7	0.0	5.6	-0.1	27.0

Në ndryshim nga struktura e zakonshme e inflacionit, ndikimi i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse” në ecurinë e inflacionit ka qenë më i fuqishëm sesa ndikimi i grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” gjatë gjashtëmuajorit të parë.

Grafik 14. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor total (në pikë për qindjeje).






Ndikimi i grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” në inflacion ka qenë mjaft i ulët gjatë gjashtëmuajorit të parë, duke arritur një vlerë të dukshme negative në muajin maj. Kjo ecuri është diktuar nga rënia e çmimeve të artikujve të këtij grupi si pasojë e hyrjes së prodhimit bujqësor vendas. Në krahasim me vitin e kaluar, prodhimi bujqësor vendas ka qenë më i bollshëm duke bërë që efekti sezonal<sup>2</sup> gjatë vitit 2004 të jetë më i hershëm dhe më i fortë. Ndërsa në vitin 2003, vetëm muaji qershor reflektoi ndjeshëm mbizotërimin e tregut nga prodhimi vendas dhe më pas efekti sezonal u shua herët. Gjatë vitit 2004 muajt maj – qershor pasqyruan dukshëm këtë efekt.

Kontributi i grupit “Transport” në inflacionin vjetor të qershorit ishte 0.12 pikë për qindjeje. Rritja e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar, duke arritur maksimumin në muajin maj, në 40.3 \$/barel solli rritjen e çmimit të këtij produkti dhe në tregun tonë. Inflacioni vjetor i këtij grupi vazhdoi rritjen nga 1.5 për qind në muajin maj në 2.5 për qind në muajin qershor.

Grupi “Komunikimi” ka dhënë një kontribut të qëndrueshëm prej 0.67 pikë për qindjeje në inflacionin vjetor që prej dhjetorit 2003. Ulja e tarifave të telefonisë fikse solli reduktimin e inflacionit të grupit “Komunikimi” me 37.5 pikë për qindje nga muaji mars në muajin prill. Kështu, kontributi i këtij grupi në inflacion u ul në 0.21 pikë për qindje në muajin prill 2004.

Grafik 15. Inflacioni vjetor.




<sup>2</sup> Oferta vendase mbizotëron tregun e brendshëm të vendit tonë gjatë muajve të verës, duke zëvendësuar mallrat ushqimorë të importit dhe duke sjellë uljen e çmimeve të produkteve ushqimorë.

### I.3.1 FAKTORËT QË KANË NDIKUAR NË ECURINË E INFLACIONIT.


Faktorët e kërkesës kanë dhënë një ndikim pozitiv në zhvillimet e inflacionit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004. Ashtu si dhe gjatë vitit të kaluar, situata e qëndrueshme e likuiditetit, mbajtja nën kontroll e agregatëve monetarë, ruajtja e financimit të brendshëm brenda kufirit të lejuar dhe shpërndarja më e njëtrajtshme e tij gjatë vitit, kanë krijuar një ambient të përshtatshëm monetar për kontrollin e inflacionit.

Grafik 16. Ndryshimet vjetore të agregatëve monetarë M1 dhe M3 (në për qindje).



Politika fiskale nuk ka ushtruar presione inflacioniste gjatë këtij gjashtëmujori. Shpenzimet buxhetore janë rritur në mënyrë të kontrolluar duke mbetur brenda niveleve të planifikuara. Ato kanë kontribuar në qëndrueshmërinë e kërkesës së ekonomisë.

Grafik 17. Ecuria e shpenzimeve buxhetore të vitit 2004 (në përqindje ndaj PBB-së).




Nga ana tjetër, ndikimi i faktorëve të ofertës ka qenë i dykrahshëm. Gjatë tremujorit të parë të vitit, inflacioni është ndikuar negativisht nga faktorët e ofertës, si rritja e çmimit të energjisë, e çmimit të bukës dhe e çmimit të transportit. Gjithashtu, edhe indeksi i çmimeve të prodhimit ka shënuar rritje me 4.12 për qind<sup>3</sup> në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2003, duke ndikuar në rritjen e presioneve inflacioniste. Gjatë tremujorit të dytë, korigjimi në zbritje i tarifave të telefonisë fikse dhe i çmimit të bukës, në muajin prill, si dhe hyrja e

<sup>3</sup>. Burimi i të dhënave INSTAT.

prodhimit vendas në tregun e brendshëm ndikuan në uljen e normës së inflacionit.

Grafik 18. Ecuria e indeksit të çmimeve të prodhimit në vitet 2000 – 2004.



Burimi: INSTAT.

Inflacioni i importuar ka dhënë një ndikim modest në inflacionin në vend gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004. Normat e ulëta të inflacionit<sup>4</sup> të regjistruara në vendet partnere të shkëmbimeve tregtare, të kombinuara me mbiçmimin, në bazë vjetore të lekut ndaj euros dhe dollarit përkatësisht me 10 për qind dhe 13.6 për qind, kanë zbutur efektin e këtij faktori.

Tabelë 13. Inflacioni vjetor i vendeve kryesore partnere (në për qind).

	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor '03	Janar '04	Shkurt	Mars	Prill	Maj
Greqi	3.3	3.3	3.4	3.1	3.1	2.6	2.9	3.1	3.1
Itali	3.0	2.8	2.8	2.5	2.2	2.4	2.3	2.3	2.3

Burimi: Infobase European Resource.


<sup>4</sup> Normat e regjistruara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004 janë më të ulëta në krahasim me ecurinë e inflacionit të këtyre vendeve gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2003.

### III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

#### I.4 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Rritja e kostove të prodhimit si pasojë e rritjes së çmimeve të administruara të energjisë dhe të telefonisë fikse, nuk u shoqërua me rritje të dukshme të çmimit të mallrave përfundimtarë. Kushtet monetare në ekonomi kanë favorizuar ruajtjen e inflacionit në nivele të ulëta, duke bërë që rritja e çmimeve të administruara të transmetohet në inflacion vetëm në formën e efektit direkt. Paraja ka vijuar të kthehet në sistem me ritme të shpejta në banka, ndërsa kursi i këmbimit të lekut ka qenë përgjithësisht i qëndrueshëm, madje me tendencë të lehta mbiçmuese. Kthimi i parasë në sistem ka përmirësuar treguesit e likuiditetit të sistemit bankar dhe ka ndikuar në uljen e agregatit M1, i cili ka ndikimin kryesor në inflacion.

Grafik 19. Rritja vjetore e M1 real.




Në përgjigje të këtyre zhvillimeve Banka e Shqipërisë ndoqi një politikë monetare neutrale gjatë tremujorit të parë. Ajo ruajti të pandryshuar normën bazë të interesit dhe përdori ankandet e repove me çmim fiks për tërhequr likuiditetin e tepërt të sistemit bankar gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, për të zbutur presionet rënëse mbi normat e interesit, Banka e Shqipërisë tërhoqi 4.5 miliardë lekë likuiditet në muajin mars, me anë të shitjeve me të drejta të plota të bonove të thesarit të portofolit të saj.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë mori një prirje të qartë zbutëse gjatë tremujorit të dytë. Rishikimi në ulje i disa çmimeve të administruara dhe futja në treg e prodhimit bujqësor vendas, bënë që inflacioni të rikthehet brenda objektivit 2 – 4 për qind, duke iu afruar pas muajit maj kufirit të poshtëm të tij. Ulja e nivelit të inflacionit solli një rritje të normës reale të interesit. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 arriti në nivelin minimal historik në muajin maj, 25.4 për qind. Ndërkohë, stabiliteti i kushteve monetare dhe niveli i kontrolluar i inflacionit kanë ndikuar në rritjen e besimit ndaj lekut. Këta faktorë, së bashku me rritjen e

prodhimit bujqësor vendas në tremujorin e dytë, kanë ndikuar në forcimin e lekut gjatë kësaj periudhe.

Qëndrueshmëria e inflacionit brenda objektivit si dhe perspektiva pozitive e tij bënë që Banka e Shqipërisë të lehtësojë më tej kushtet monetare, duke ulur normën bazë të interesit. Ulja e normës së interesit u krye në tre faza: në datat 28 prill, 12 maj dhe 23 qershor. Duke qenë se çdo ulje e ka çuar normën bazë të interesit në minimume të reja historike, Banka e Shqipërisë ka proceduar me kujdes duke e ulur normën bazë të interesit me 0.25 pikë për qindjeje në çdo rast. Në fund të këtij cikli uljesh, norma bazë e interesit zbriti në nivelin 5.75 për qind.

Grafik 20. Ecuria e normës bazë të interesit.



Reduktimi i koston së lekut do të shërbejë për të nxitur kreditimin në lekë të ekonomisë, për të ulur koston e borxhit të qeverisë dhe për të zbutur presionet mbiçmuese të lekut. Efektet e kësaj uljeje janë vënë re së pari në tregun bankar. Bankat e nivelit të dytë kanë ulur normat e interesit të depozitave në lekë, të bonove të thesarit dhe të kredisë në lekë.

Politika monetare lehtësuese është mbështetur nga ndryshimi i formës së instrumentit të repove, nga ankand me çmim fiks në ankand me shumë fikse dhe çmim të luhatshëm. Kjo ka ndihmuar në rritjen e presionit për uljen e normave të interesit të aplikuara nga bankat e nivelit të dytë. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme edhe në tregun valutor, kryesisht në pozicion pritës, duke synuar të plotësojë ofertën e valutës në treg. Gjithsesi, aktiviteti real i saj në tregun valutor ka qenë i vogël gjatë gjashtëmujorit të parë.

Banka e Shqipërisë ka vazhduar të respektojë objektivat e saj sasiorë. Lehtësimi i kushteve monetare nuk pritet të çënojë realizimin e mëtejshëm të tyre.

Tabelë 14. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.

	Dhje '03	Mar '04	Pri '04	Maj '04	Qer '04**
<b>Rezerva ndërkombëtare neto* (në milionë dollarë)</b>					
Objektivi	715.8	751.8	756.5	761.2	765.8
Aktuale	832.7	827.6	965.2	962.1	914.0
Diferenca	116.8	75.8	208.7	201.0	148.2
<b>Mjetet e brendshme neto (në miliardë lekë)</b>					
Objektivi	96.0	83.0	83.6	84.3	85.0
Aktuale	72.0	66.4	51.3	51.3	59.7
Diferenca	-24.0	-16.6	-32.3	-33.0	-25.2
<b>Kredia e brendshme neto për qeverinë (në miliardë lekë)</b>					
Objektivi	268.1	274.1	274.1	271.4	-
Aktuale	268.1	273.9	273.9	271.6	-
Diferenca	0.0	-0.2	-0.2	0.2	-


\*Duke filluar nga muaji mars 2004, ky objektiv llogaritet sipas një standardi të ri.

\*\* Të dhëna operative.

## 1.5 ECURIA E AGREGATËVE MONETARË

Gjashtëmujori i parë i vitit është karakterizuar nga një rritje e qëndrueshme e ofertës monetare. Mesatarisht, norma vjetore e rritjes së agregatit M3 gjatë kësaj periudhe është 8.2 për qind, nivel ky nën mesataren historike të viteve të kaluara. Oferta monetare në lekë ka shfaqur një ngadalësim në ecurinë e saj, duke reflektuar pjesërisht kërkesën mjaft të ulët të qeverisë për para në pjesën e parë të vitit. Struktura kohore e ofertës monetare ka vazhduar zhvendosjen e saj drejt mjeteve më pak likuide, ndërkohë që rritja e ndjeshme e depozitave në valutë ka rezultuar në rritjen e peshës së përbërësit valutë në parandëgjithë.

Grafik 21. Grafik : Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.




Në fund të muajit maj, oferta monetare shënoi një normë rritjeje vjetore prej 9.0 për qind. Kontributin më të madh në këtë rritje e kanë dhënë depozitat në valutë, normat vjetore të të cilave kanë qenë në rritje gjatë gjithë periudhës. Norma e rritjes vjetore të depozitave në valutë, në fund të muajit maj, arriti në 17.4 për

qind. Në mungesë të efektit negativ të mbiçmimit të lekut, që në terma vjetorë vlerësohet të jetë rreth 11.1 miliardë lekë, kjo normë do të rezultonte në 29.6 për qind. Rritja e tyre ka qenë kryesisht në formën e depozitave në valutë pa afat, të cilat në pesë muajt e fundit janë rritur me 7.1 miliardë lekë nga 8.2 miliardë lekë e rritjes në total. Ecuria e depozitave në valutë me afat gjatë kësaj periudhe ka qenë në nivele të ulëta, si pasojë e normave mjaft të ulëta të interesit të ofruara për to.

Ecuria e raportit të parasë jashtë bankave ndaj parasë gjithsej, tregon për rënien e vazhdueshme të tij drejt niveleve më të ulëta historike. Niveli i këtij raporti në muajin maj arriti në 25.4 për qind duke shënuar një rënie prej 2.5 pikë për qindjeje që prej muajit dhjetor. Kjo ecuri ka reflektuar rritjen e vazhdueshme të besimit në sistemin bankar si edhe numrin në rritje të shërbimeve bankare për klientët, në kushtet kur normat reale pozitive të interesit kanë ruajtur nxitjen për investimin e kursimeve në depozita me afat në lekë. Megjithatë, ecuria në rënie e normave të interesit duket se ka ndikuar në stabilizimin e raportit të parasë jashtë bankave, gjë vihet re në ngadalësimin e tendencës rënëse të tij në muajt e fundit.

Grafik 22. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 dhe normat reale të interesit.



Normat vjetore të rritjes së depozitave në lekë kanë qenë në rënie gjatë gjithë periudhës, duke përforçuar tendencën e tyre të përafrimit me normat vjetore të agregatit M2. Në fund të muajit maj, norma e rritjes vjetore të depozitave në lekë ra në 11.6 për qind nga 15.7 për qind që ishte në fund të vitit 2003. Ndërkohë, procesi i kthimit të parasë në sistem ka vazhduar edhe gjatë këtij gjashtëmujori, duke bërë që normat vjetore të ndryshimit të parasë jashtë bankave të mbeten në nivele negative. Në muajin maj kjo normë ka rezultuar në -2.1 për qind.

Tabelë 15. Ecuria e treguesve monetarë në muajin maj (në miliardë lekë).

	Maj 2004	Ndryshimi 5-mujor		Ndryshimi vjetor	
		Absolut	Për qindje	Absolut	Për qindje
Paraja jashtë bankave	117.1	-8.1	-6.4	-2.6	-2.1
Depozitat totale	343.1	19.9	6.2	40.5	13.4
- në lekë	236.0	11.7	5.2	24.6	11.6
- në valutë	107.1	8.2	8.3	15.9	17.4


Depozita pa afat	66.7	10.1	17.9	9.9	17.5
- në lekë	22.5	3.0	15.3	0.3	1.5
- në valutë	44.2	7.1	19.3	9.6	27.8
Depozita me afat	276.4	9.7	3.7	30.6	12.4
- në lekë	213.5	8.7	4.3	24.3	12.8
- në valutë	62.9	1.0	1.7	6.3	11.1
M1	139.7	-5.1	-3.5	-2.2	-1.6
M2	353.2	3.6	1.0	22.0	6.7
M3	460.3	11.8	2.6	37.9	9.0
Baza monetare	153.7	-6.9	-4.3	1.2	0.8

## I.6 KËRKESA E BRENDSHME

### I.6.1 POZICIONI VALUTOR I SISTEMIT BANKAR.

Rritja e depozitave në valutë dhe hyrja e të ardhurave të privatizimit, kanë ndikuar në përmirësimin e pozicionit valutor të sistemit bankar gjatë pjesës së parë të vitit. Mjetet valutore neto të sistemit bankar janë rritur me 183.5 milionë usd gjatë pesë muajve të parë të vitit. Kjo ecuri ka çuar në një kontribut të lartë të këtyre mjeteve në rritjen e mjeteve monetare në ekonomi.


Grafik 23. Kontributi i mjeteve valutore neto në rritjen e M3.



Gjatë periudhës janar – maj 2004, Banka e Shqipërisë rezulton me mjete valutore neto të rritura me rreth 122.8 milionë usd. Kjo rritje është rezultat i hyrjes në rezervat valutore të të ardhurave të privatizimit të Bankës së Kursimeve, prej 126 milionë dollarësh. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor, kryesisht në mënyrë pasive dhe si partner kryesor ka patur Ministrinë e Financave.



Grafik 24. Ecuria e mjeteve valutore neto të sistemit bankar.




Për të njëjtën periudhë të vitit 2004, mjetet valutore të bankave të nivelit të dytë kanë njohur një rritje prej 60 milionë usd. Periudha janar-maj është shoqëruar me rritje të depozitave në valutë me rreth 8.2 miliardë lekë, ndërsa teprica e kredisë në valutë është rritur me 5.0 miliardë lekë.

### 1.6.2 FINANCIMI I DEFICITIT BUXHETOR

Llogaritë fiskale për muajin maj shënojnë një deficit buxhetor prej 5.2 miliardë lekësh. Thellimi i këtij deficiti është vërejtur kryesisht në muajin prill dhe maj. Gjithsej, financimi për periudhën janar – maj 2004, arriti vlerën 7.6 miliardë lekë, dhe ishte pothuajse i tëri financim i brendshëm dhe nga sistemi bankar.

Format e financimit gjatë këtij gjashtëmujori kanë qenë emetimi i bonove të thesarit dhe i obligacioneve dyvjeçare. Në muajin maj, pjesë e financimit të brendshëm ka qenë dhe e ardhura nga privatizimi i Bankës së Kursimeve në shumën 3.5 miliardë lekë. Ky burim financimi do të jetë në përdorim dhe për pjesën në vazhdim të vitit, me rreth 3.1 miliardë lekë duke bërë të mundur uljen e kërkesës së qeverisë për financim nga sistemi bankar. Gjatë pesë muajve të parë të vitit 2004, bankat e nivelit të dytë dhe individët kanë rritur portofolin e bonove të thesarit përkatësisht me rreth 6.4 miliardë lekë dhe 2.7 miliardë lekë. Ndërsa institucionet financiare jobanka dhe Banka e Shqipërisë kanë ulur portofolet përkatësisht me 1.2 dhe 8 miliardë lekë. Nëpërmjet emetimit të obligacioneve qeveritare që nga fillimi i vitit është siguruar një financim prej 1.8 miliardë lekësh.

Grafik 25. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).



### I.6.3 KREDIA PËR EKONOMINË.

Kreditimi i ekonomisë njohu ritme të shpejta zhvillimi gjatë pesë muajve të parë të vitit 2004. Ekonomia, si pesëmuor është kredituar me 5.5 miliardë lekë ose 25 për qind më e lartë se e njëjta periudhë e vitit 2003. Teprica e kredisë në fund të muajit maj të vitit 2004 arriti në 56.2 miliardë lekë. Gjatë periudhës janar –maj 2004, ashtu si edhe gjatë vitit 2003, pjesa që zë krediti për ekonominë në kërkesën për para ka ardhur duke u rritur, kurse kredia për qeverinë ka patur tendencë në rënie. Në fund të muajit maj të vitit 2004, kredia për ekonominë përbën 12.2 për qind të kërkesës për para.

Tabelë 16. Ecuria e disa treguesve kryesorë.

	2000	2001	2002	2003	T1'04	Prill '04	Maj '04
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	328.1	393.6	416.7	448.4	456.0	456.7	460.3
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	75.5	67.5	70.8	71.5	71.6	69.0	68.9
- Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	68.4	60.4	61.5	60.2	59.9	56.7	56.6
- Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	7.1	7.1	9.3	11.3	11.7	12.2	12.2
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	8.6	8.9	11.5	13.7	13.7	14.3	14.3
Raporti kredi/depozita (në %)	10.1	10.2	13.5	15.6	15.8	16.5	16.4

Përmirësime të vazhdueshme janë shënuar si në zgjerimin e rrjetit të shërbimit bankar ashtu edhe në marrëdhëniet institucionale kredidhënës-kredimarrës. Kështu, ka ardhur duke u rritur ndërgjegjësimi i klientëve në drejtim të korrektesës që shoqëron marrëdhënien huamarrës dhe huadhënës dhe në përgjithësi, të forcimit të marrëdhënieve ndërmjet biznesit dhe sistemit bankar. Një fakt i tillë konkretizohet me nivelin e lartë të lëvrimit të kredive të reja, të cilat kanë shënuar rritje nga një periudhë në tjetrën. Gjithashtu, treguesit e cilësisë së kreditimit konfirmojnë përmirësimin e marrëdhënieve bankë-biznes. Kështu, përqindja e kredive me probleme është ulur me 0.2 përqindjeje gjatë pesë muajve të parë të vitit, duke arritur në 4.4 për qind në fund të muajit maj.

Ecuria e tepricës së kredisë sipas afateve kohore paraqitet me rritje të tepricës së kredisë afatmesme dhe asaj afatgjatë, e cila në fund të muajit maj, zinte në total 61.5 për qind të tepricës së kredisë. Gjatë vitit 2004 konstatohet rënie e vazhdueshme e tepricës së kredisë afatshkurtër. Kjo kredi ka pësuar një rënie prej 7.5 pikë për qindjeje krahasuar me fundin e vitit 2003.

Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të dominohet nga kredia në valutë. Në fund të muajit maj 2004 kredia në valutë përbënte rreth 83 për qind të totalit të kredisë. Mbiçmimi i lekut ndaj dy monedhave kryesore, euro dhe usd, gjatë 5 muajve të parë të vitit 2004, respektivisht me rreth 2 për qind dhe 5 për qind, ka reduktuar me rreth 1.7 miliardë lekë, vlerën në lekë të tepricës të kredisë në valutë. Duke e eliminuar këtë efekt, rezulton se rritja reale e tepricës së kredisë është 7.2 miliardë lekë.

Tabelë 17. Ecuria e treguesve të tepricës së kredisë, në për qindje.

	2002	2003	T-1 '04	Prill '04	Maj '04
Kredi afatshkurtër	53.8	46.0	41.6	40.8	38.5
Kredi afatmesme	30.1	33.3	35.4	35.9	37.1
Kredi afatgjatë	16.1	20.7	23.0	23.4	24.4
Spektori privat <sup>5</sup>	99.8	100.0	100.0	100	100
Spektori shtetëror	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0
Lekë	21.3	19.6	17	17	17 <sup>6</sup>
Valutë	73.7	80.4	83	83	83
Teprica e kredisë (në mld lekë)	38.7	50.7	53.4	55.97	56.2

Niveli i kredive të reja të lëvruara në periudhën janar-maj të vitit 2004 arriti në 48.7 miliardë lekë ose 47 për qind më i lartë se niveli i kredive të lëvruara në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rreth 50 për qind e kredive të reja janë akorduar për qëllime tregtare, 9 për qind për industrinë përpunuese dhe 10 për qind për blerjen e pasurive të patundshme. Pjesa tjetër i takon degëve të ndërtimit, hotele e restorante, transport e telekomunikacion dhe shumë pak bujqësisë. Megjithatë, niveli i kredive të lëvruara për sektorin e bujqësisë gjatë periudhës janar-maj 2004 rezulton rreth 78 për qind më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2003.

Tabelë 18. Ecuria e kredisë së re në vite (në miliardë lekë).

	2001	2002	2003	T-1 '04	Prill'04	Maj'04
Kredi afatshkurtër	27.6	44.7	63.1	18.7	6.9	6.5
Kredi afatmesme	10.4	13.0	22.2	5.7	2.3	2.5
Kredi afatgjatë	2.6	4.8	7.4	3.5	1.4	1.2
Spektori shtetëror	0.5	0.06	0.04	0.0	0.0	0.0
Spektori privat	40.1	62.5	92.6	27.9	10.6	10.2
Lekë	10.0	20.8	30.8	8.80	2.4	3.9
Valutë	30.6	41.8	61.8	19.10	8.2	6.3
Kredi e re (në mld lekë)	40.6	62.6	92.6	27.9	10.6	10.2


Në pjesën e parë të vitit 2004, në strukturën sipas degëve të ekonomisë të tepricës së kredisë gjithsej, vërehet një tendencë në rënie e peshës që zë kredia për sektorin e tregtisë dhe rritje e vazhdueshme e kredisë për pasuri të

<sup>5</sup> Në këtë klasifikim 99 për qind i takon sektorit privat dhe individëve dhe 1 për qind institucioneve financiare.

<sup>6</sup> Në muajin maj të vitit 2004 Banka Amerikane e Shqipërisë në raportimet e saj për aktivitetin kreditues të saj ka kryer disa sistemime në strukturën e tepricës së kredisë sipas afateve dhe monedhave. Këto sistemime u kryen që nga muaji dhjetor i vitit 2003.

patundshme. Nga ana tjetër, sektori i bujqësisë ka filluar që të mbështetet financiarisht me kredi bankare. Kjo shihet qartë po të krahasojmë me vitin 2000 ritmin e rritjes së kreditimit në këtë sektor (grafiku më poshtë). Në fund të muajit maj 2004, teprica e kredisë që i takon sektorit të bujqësisë rezulton 4 herë më e lartë se ajo në vitin 2000.

Grafik 26. Indeksi i rritjes së tepricës së kredisë sipas disa sektorëve të ekonomisë.



Për vitin 2004 në programin monetar është parashikuar që rritja e kreditimit të sektorit privat të jetë 16.5 miliardë lekë. Deri në fund të muajit maj 2004 niveli i parashikuar është realizuar në masën 33.3 për qind. Duke marrë parasysh faktin që në gjashtëmuorin e dytë bankat rrisin nivelin e portofolit të kredisë si dhe hyrjen në tregun e kredisë edhe të Bankës së Kursimeve, mendojmë se niveli i parashikuar në programin monetar për kreditimin e ekonomisë nga sistemi bankar do të realizohet.

Tabelë 19. Teprica e kredisë sipas degëve të ekonomisë (në për qindje).


	2001	2002	2003	T-1 '04	Maj '04
1 Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	1.0	0.8	1	1.0	1.1
2 Peshkimi	0.1	0.2	0	0.1	0.1
3 Industria nxjerrëse	1.6	0.2	1	0.2	0.2
4 Industria përpunuese	19.5	17.0	17	16.9	<b>18.0</b>
5 Prodhimi, shpërndarja energji elektrike, gaz dhe ujë	3.0	3.3	3	3.0	3.2
6 Ndërtimi	12.5	8.6	10	9.7	10.8
7 Tregtia, riparimi i automobilave dhe artikujve shtëpiakë	41.3	40.4	34	31.4	<b>25.3</b>
8 Hotele dhe restorante	4.3	6.0	6	7.1	7.8
9 Transporti dhe telekomunikacioni	4.6	2.4	1	2.0	1.3
10 Aktivitete financiare	0.1	-	0	0.1	0.2
11 Pasuritë e patundshme	6.3	9.1	13	13.7	<b>14.7</b>
12 Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	1.2	0.5	0	0.5	0.5
13 Shërbime kolektive, sociale dhe personale	3.3	4.2	8	4.2	4.5
14 Të tjera	1.2	7.3	4	10.1	12.2
Totali	100	100	100	100.0	100.0

## I.7 TREGJET FINANCIARE DHE ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT

### I.7.1 ZHVILLIMET KRYESORE NË TREGJET FINANCIARE

Sistemi bankar ka vijuar të rezultojë me tepriçë likuiditeti edhe gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2004. Niveli i likuiditetit gjatë kësaj periudhe, në përgjithësi, ka paraqitur qëndrueshmëri duke u luhatur mesatarisht në shifrën 5.1 miliardë lekë.

Grafik 27. Likuiditetet e bankave tregtare pranë Bankës së Shqipërisë (në milionë lekë).



Tërheqja e likuiditetit është bërë kryesisht me ankande të repove njëjavore me shumë të pakufizuar. Ndërkohë fundi i qershorit dhe fillimi i muajit korrik është shoqëruar me shenja të rritjes së nivelit të likuiditetit, duke bërë të nevojshme ndërhyrjen me ankande të shpejta dhe me ankande të repove njëmuajore. Depozita njëditore ka qenë një nga lehtësitë e preferuara për bankat tregtare, ndërsa kredia njëditore është përdorur rrallë.

Me prezantimin e sistemit të ri të pagesave AIPS, në muajin mars filloi të praktikohet dhe kredia ndërditore. Kjo lehtësi ka gjetur përdorim nga një numër bankash, kryesisht të atyre që kanë qenë më aktivet dhe në tregun ndërbankar.

Tepria e likuiditetit nuk ka nxitur transaksionet në tregun ndërbankar. Mesatarisht, vëllimi i transaksioneve ka shënuar vlerën 0.4 miliardë lekë krahasuar me 0.7 miliardë lekë në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2003, kur sistemi bankar pati periudha të mungesës së likuiditetit.

Në tregun primar, kërkesa e qeverisë për fonde ka qenë e përballeshme nga bankat. Oferta e tyre për të investuar në letra me vlerë të qeverisë ka qenë më e lartë sesa shuma e shpallur, sidomos për bonot e thesarit me maturitet njëvjeçar, duke rritur konkurrencën e bankave në këtë treg. Ulja e *yield*-it në vijim të lehtësimit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë dhe rritjes së konkurrencës, ka bërë që efekti neto i emetimeve dhe imaturimeve të letrave me vlerë të qeverisë të jetë negativ. Kjo ka sjellë çlirimin e fondeve të sistemit dhe

rritje të likuiditetit, ndërkohë që për mbulimin e deficitit buxhetor kanë shërbyer edhe kredia direkte dhe të ardhurat nga privatizimi.

### I.7.2 ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT


Përgjatë gjysmës së parë të vitit 2004, Banka e Shqipërisë ka sinjalizuar lehtësim të politikës monetare duke ndërmarrë tre ulje të njëpasnjëshme prej 0.25 pikë për qindjeje të normës së repos. Në fund të muajit qershor, norma e repos arriti në 5.75 për qind. Me përjashtim të tregut të kredive, duket se këto sinjale janë përcuar në të gjitha tregjet.

Tabelë 20. Interesat mesatarë të ponderuar të fluksit të ri të depozitave; të kredive të dhëna dhe të bonove të thesarit, gjatë vitit 2004.

	dhjetor-03	mars-04	maj-04	Ndryshimi kumulativ
Repo	6.50	6.50	6.00	-0.50
Depozita me afat në lekë	6.29	5.75	5.59	-0.70
Bono thesari	8.57	8.25	8.1	<b>-0.47</b>
Kredi në lekë	11.34	11.66	12.72	<b>+1.38</b>

Duket se bankat kanë preferuar të ulin më shumë interesat e depozitave në lekë sesa *yield*-in e bonove të thesarit, duke siguruar kështu një fitim më të madh. Madje, ulja e interesit të depozitave në lekë, ka qenë më e madhe edhe se ulja e sinjalizuar nga Banka e Shqipërisë. Këtë reagim të tyre e ka mbështetur dhe fakti që depozitat në lekë kanë patur tendencë rritëse. Ndërkohë, normat e interesit në tregun e kredive kanë patur një tendencë të lehtë rritëse, si pasojë e zhvendosjes së strukturës së kredisë drejt kredive afatgjata.

Grafik 28. Ecuria e normës së interesit të depozitave dhe kredive në lekë.




Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004, trendet e interesave mesatarë të depozitave në valutë<sup>7</sup> kanë qenë në kahe të kundërta: rritëse për dollarin dhe rënëse për euron.

<sup>7</sup> Interesi mesatar i ponderuar i depozitave me afat.

Rritja e interesave të depozitave në usd, ka reflektuar pritshmëritë e tregjeve ndërkombëtare për një politikë shtrënguese nga ana e Fed-it, e cila u bë realitet në fund të muajit qershor.


Ndërkohë, ulja e interesave të depozitave në euro, ka reflektuar pritshmëritë e tregjeve për lehtësim të mëtejshëm të politikës monetare, nga Banka Qendrore Evropiane. Kësaj i shtohet dhe rritja e depozitave në euro pranë bankave (gati tre herë më shumë se rritja e depozitave në dollarë<sup>8</sup>), kostoja më e lartë e pranimit të depozitave në euro dhe preferenca e bankave për ta ulur atë, mbiçmimi i dollarit në tregjet ndërkombëtare, duke rritur interesimin e bankave për të etj..

Grafik 29. Ndryshimi gjashtëmujor i interesave mesatarë të ponderuar të depozitave



dhe kredive në usd.


Grafik 30. Ndryshimi gjashtëmujor i interesave mesatarë të ponderuar të depozitave dhe kredive në euro.



Me ndjekjen e një politike lehtësuese të Bankës së Shqipërisë, *spread*-i midis interesave të depozitave lekë-valutë, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2004, ka ardhur duke u ngushtuar.

<sup>8</sup> Sipas të dhënave operative, të shprehura në dollarë dhe në euro.

Grafik 31. Spread-i midis interesave të depozitave me afat në lekë me ato në valutë.




Megjithatë, preferencat për lekun nuk kanë rënë, në kushtet kur interesat e depozitave në valutë kanë qenë në nivele të ulëta.

### 1.7.3 ZHVILLIMET NË TREGUN VALUTOR

Në kushtet e stabilitetit ekonomik, të rritjes së besimit ndaj monedhës vendase dhe efektit sezonal, në gjashtëmujorin e parë 2004, leku është mbiçmuar si ndaj euros ashtu dhe dollarit me përkatësisht 6.4 për qind dhe 5.4 për qind.

Grafik 32. Kursi i këmbimit në tregun e brendshëm valutor



Fillimi i turizmit më herët se në vitet e mëparshme ka ndikuar në rritjen e ofertës së valutës nga turistët e emigrantët duke ndihmuar në mbiçmimin e lekut. Në kahun e kërkesës së ulët për valutë të huaj ka ndikuar rritja e prodhimit vendas dhe ulja e kërkesës për importe të mallrave bujqësore. Në kahun e kërkesës për lekë, qeveria gjatë këtij gjashtëmujori ka shfaqur një kërkesë të ulët për financim të deficitit e ndihmuar edhe nga hyrja e të ardhurave nga privatizimi i Bankës së Kursimeve.

Nga ana tjetër edhe pse normat e interesave në lekë kanë qenë në ulje të vazhdueshme gjatë pjesës së parë të vitit, normat e ulëta të inflacionit kanë mbajtur normat reale të interesit në lekë më të larta se normat e interesit në valutë. Këto të fundit janë ulur si pasojë e politikave lehtësuese të Fed-it dhe ECB-së. Të gjitha këto duket se kanë mbështetur fuqizimin e lekut. Preferenca



për lekun është vërejtur si në rritjen e depozitave në lekë ashtu dhe në rritjen e interesimit të publikut për bonot e thesarit në këtë monedhë.

Mbiçmimi i lekut nuk ka patur ndonjë efekt të dukshëm në rënien e eksporteve pasi në masën më të madhe të tyre, ato përbëhen nga ri-eksporte. Të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2004, tregojnë për rritje të eksporteve, krahas rritjes së importeve.

Për të ruajtur stabilitetin e kursit të këmbimit, krahas uljes së normës bazë të interesit, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në treg duke blerë valutë.

## II. ECURIA E PRITSHME EKONOMIKE GJATË VITIT 2004

Objektivat e përgjithshëm të zhvillimit makroekonomik të vendit për vitin 2004, përmbliohen në arritjen e ritmit të rritjes së ekonomisë rreth 6 për qind, që parashikohet të realizohet në kushtet e ruajtjes së stabilitetit makroekonomik, të një inflacioni brenda intervalit 2-4 për qind, të një deficiti buxhetor në rënie, të një pozicioni të qëndrueshëm të bilancit të përgjithshëm të pagesave, të shprehur me rritjen e rezervave valutore dhe me një kurs këmbimi relativisht të qëndrueshëm. Sektorët më dinamikë të ekonomisë shqiptare: ndërtimi, transporti dhe shërbimet, vazhdojnë të japin kontributin kryesor në rritjen ekonomike.

Tabelë 21. Rritja e parashikuar e sektorëve të ekonomisë (në për qindje).

	2002	2003	2004
Rritja reale e PBB	4.7	6.0	6.2
-industria	1.8	2.7	3.1
-bujqësia	2.1	3	3.0
-ndërtimi	8.7	11.3	10.6
-transporti	9.7	10.8	10.1
-shërbime	5.1	6.4	6.4

Në përgjithësi, të dhënat e viteve të fundit tregojnë konsolidim të ekuilibrit makroekonomik. Inflacioni është mbajtur brenda objektivit dhe në nivele modeste krahasuar me standardet e vendeve në zhvillim, monedha vendase ka qenë e qëndrueshme, duke shfaqur së fundi edhe tendenca mbiçmimi; politika fiskale ka lëvizur brenda parametrave të parashikuar, ndërsa treguesit monetarë paraqiten të stabilizuar. Kreditimi i ekonomisë duket se ka marrë një hov të ri, duke shënuar një rritje mesatare vjetore prej 30 për qind gjatë tre viteve të fundit ndërsa sistemi bankar paraqitet i shëndoshë dhe me tregues të kënaqshëm likuiditeti dhe rentabiliteti.

Ekonomia shqiptare parashikohet të lëvizë brenda linjave të këtij stabiliteti edhe gjatë vitit 2004. Politikat fiskale dhe monetare janë orientuar drejt këtij objekti, duke krijuar kështu një ambient të përshtatshëm për rritjen ekonomike.

Tabelë 22. Treguesit kryesorë makroekonomikë.

	2001	2002	2003	2004
<b>Treguesit monetarë (në për qindje)</b>				
Rritja PBB	7.6	4.7	6.0	6.2
IÇK vjetor (mesatar)	3.1	5.2	2.4	3.0
PBB nominale (miliardë lekë)	610.4	677.7	744.6	836.9
<b>Treguesit fiskalë (në për qindje ndaj PBB-së)</b>				
Deficiti fiskal	-8.2	-6.9	-4.7	-6.5

Huamarrja e brendshme	3.0	3.2	2.7	1.9
Borxhi i brendshëm publik	39.5	38.8	38.0	35.9
<b>Sektori i jashtëm (në milionë usd)</b>				
Deficiti tregtar	-1027	-1155	- 1336	-1602
Transfertat private	543	597	782	939
Rezerva valutore bruto	737	860	1026	1133
<b>Treguesit monetarë (në për qindje)</b>				
Rritja M3	19.9	7.0	9.5	11.8
Rritja e kredisë për ekon.	43.1	32.1	28.5	31.54
Normat e interesit të bth 3m	8.0	11.2	7.3	...

### Sektori i jashtëm

Sektori i jashtëm i ekonomisë do të vazhdojë të karakterizohet nga deficite të larta tregtare. Ky fakt dëshmon për konsumin e lartë të ekonomisë shqiptare, konsum i cili financohet ndjeshëm nga transfertat private të emigrantëve. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 20 për qind gjatë vitit 2004, duke arritur në 939 milionë usd. Nga ana tjetër, ky deficit tregon edhe për konkurrencialitetin, i cili shfaqet në vështirësinë që hasin eksportet shqiptare në tregjet e huaja dhe në pamundësinë e tyre për të zëvendësuar efektivisht një pjesë të mallrave të importit. Deficiti tregtar parashikohet të arrijë në 20.4 për qind të PBB-së për vitin 2004, nga 21.8 për qind në vitin 2003.

Deficiti i lartë tregtar bën që Shqipëria të ketë deficite të llogarisë korente, megjithë praninë e transfertave të konsiderueshme private. Megjithatë, ulja e deficitit tregtar në terma relativë bën që edhe deficiti i llogarisë korente parashikohet të zbresë në 5.5 për qind të PBB-së gjatë vitit 2004, nga 6.5 për qind në vitin 2003. Ky deficit do të financohet nga investimet e huaja direkte dhe financimi i huaj. Në total, bilanci i pagesave parashikohet të jetë pozitiv këtë vit duke bërë që rezervat valutore bruto të Bankës së Shqipërisë të rriten me 107 milionë usd.

### Sektori fiskal

Politika fiskale e qeverisë do të vazhdojë të ketë në bazë të saj ruajtjen e stabilitetit makroekonomik duke ruajtur deficitin buxhetor në vlera të ulëta. Të ardhurat buxhetore parashikohen të arrijnë në 23.1 për qind të PBB-së, duke u rritur me 0.7 pikë për qindjeje në krahasim me vitin 2003. Të ardhurat tatimore parashikohet të arrijnë në 20.8 për qind të PBB-së nga 19.5 për qind në vitin 2003. Ndërkohë, deficiti buxhetor parashikohet të arrijë në 6.5 për qind të PBB-së. Prania e të ardhurave të privatizimit të Bankës së Kursimeve do të rrisë shpenzimet kapitale nga 5.9 për qind e PBB-së të parashikuara fillimisht në 6.3 për qind. Gjithashtu, huamarrja e brendshme do të ulet nga 2.8 për qind e PBB-së në 1.9 për qind, duke shënuar nivelin më të ulët gjatë viteve të fundit.

### **Zhvillimet monetare**

Edhe për vitin 2004, Banka e Shqipërisë do të synojë të ruajë inflacionin në intervalin 2-4 për qind. Për të arritur këtë, Banka e Shqipërisë synon të kontrollojë rritjen e mjeteve monetare në ekonomi në nivelin 11.8 për qind. Kjo rritje gjykohet se do t'i plotësojë mirë kërkesat e ekonomisë për mjete monetare, duke kontrolluar gjithashtu presionet inflacioniste. Programi monetar i Bankës së Shqipërisë për vitin 2004, parashikon rritje të mjeteve valutore neto të sistemit bankar me 14.9 për qind ose rreth 24.1 miliardë lekë, nga të cilat 9.7 miliardë lekë është rritja e mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë. Burimet e rritjes së tyre janë kryesisht hyrjet valutore nga privatizimi dhe rritja e depozitave në valutë. Të ardhurat e privatizimit mundësojnë një parashikim më të ulët se në vitin 2003 të financimit të deficitit buxhetor. Financimi i deficitit të qeverisë nga sistemi bankar gjatë vitit 2004 është projektuar të jetë 1.9 për qind e PBB-së ose 13.7 miliardë lekë, nga të cilat 12.5 miliardë lekë është parashikimi për financim nga bankat e nivelit të dytë. Gjithashtu, në programin monetar për vitin 2004, Banka e Shqipërisë parashikon rritje të tepricës së kredisë për sektorin privat me 16.4 miliardë lekë, nga të cilat 4.2 miliardë lekë do të jetë rritja e tepricës së kredisë në lekë, ndërkohë që pjesa tjetër prej 12.2 miliardë lekësh është rritja e tepricës së kredisë në valutë.

Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare në fund të vitit 2004 parashikohet 27.2 për qind. Ulja e parashikimit të raportit të parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare nga 28.6 për qind në 27.2 për qind, është kushtëzuar nga tendenca në rritje e publikut për ruajtjen e mjeteve monetare në forma më pak likuide. Ulja e raportit të PjB ndaj M3 do të favorizojë rritjen e nivelit të depozitave në lekë, të cilat gjatë vitit 2004 parashikohet të rriten me 9.7 për qind ose 21.9 miliardë lekë. Raporti i depozitave në valutë ndaj ofertës monetare në fund të vitit 2004 parashikohet 22.8 për qind, nga 20.8 për qind që ishte ky raport në fund të vitit 2003. Bazuar në këtë parashikim, rritja e depozitave në valutë të shprehura në lekë gjatë vitit 2004 do të jetë 20.8 miliardë lekë ose 22.6 për qind.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli Mbikëqyrës**

**V E N D I M**

**NR.57, DATË 28 07.2004**

**P Ë R**

**“ MIRATIMIN E ULJES SË PËRQINDJES SË INTERESAVE TË  
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLTË TË RIBLERJES ”**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, në bazë të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë uljen me 0.25 pikë përqindjeje të normës të interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (repo dhe repo të anasjellta). Norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes ulet nga 5.75 për qind, në 5.50 për qind.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare dhe Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për botimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**  
**Ylli Memisha**

**KRYETARI**  
**Shkëlqim Cani**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli Mbikëqyrës**

**V E N D I M**

**Nr.58, datë 28. 07. 2004**

**P Ë R**

**MIRATIMIN E DEKLARATËS SË BANKËS SË SHQIPËRISË**  
**“MBI KËRCËNIMIN E STABILITETIT TË SISTEMIT FINANCIAR NË**  
**SHQIPËRI”**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, hartuar në bashkëpunim me Departamentin e Politikës Monetare, me Departamentin e Kërkimeve, me Departamentin e Operacioneve Monetare dhe me Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Juridik, në bazë të nenit 69, pika 6 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë deklaratën “Mbi kërcënimin e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, për publikimin dhe dërgimin e deklaratës: në Kuvendin e Shqipërisë, në Presidencë, në Këshillin e Ministrave, në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**Ylli Memisha**

**KRYETARI**

**Shkëlqim Cani**

**Deklarata e Bankës së Shqipërisë**  
**“Mbi kërcënimin e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri”**

Banka e Shqipërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit, ka ushtruar me përgjegjësi detyrimin e saj ligjor për mbikëqyrjen e sistemit bankar, për identifikimin në kohë dhe për eliminimin e zhvillimeve, të cilat mund të përfaqësojnë një kërcënim të mundshëm për mirëfunksionimin e tij. Në bazë të ligjit, në fund të çdo gjashtëmujori Banka e Shqipërisë është e detyruar të tërheqë vëmendjen e autoriteteve të vendit, vëmendjen e tregut financiar dhe të operatorëve të tij si edhe vëmendjen e publikut të gjerë, mbi rreziqet potenciale që kërcënojnë qëndrueshmërinë e sistemit bankar në vend. Në të gjitha rastet, Banka e Shqipërisë e ka shfrytëzuar këtë mundësi që krahas identifikimit të rreziqeve potenciale për sistemin bankar, të ngrejë edhe çështje të tjera, që i shërbejnë mbarëvajtjes së tij në veprimet e përditshme si edhe që ndihmojnë në funksionimin më të mirë të sistemit financiar në përgjithësi.

Banka e Shqipërisë konstaton se në pjesën e parë të vitit 2004, u evidentuan zhvillime pozitive në sistemin bankar. Krahas zgjerimit të tij nëpërmjet hapjes së degëve të reja të bankave, përmendim që filloi të operojë një banke e re me kapital vendas si edhe përfundoi privatizimi i bankës më të madhe në vend, Bankës së Kursimeve. Numri i bankave që tani funksionojnë në vend është ngjitur në 16 dhe kushtet e konkurrencës në sistemin bankar po vijnë drejt forcimit të vazhdueshëm.

Ndër treguesit kryesorë të sistemit bankar për periudhën e kaluar, përmendim:

Treguesi	Dhjetor 2003	Maj 2004
Mjaftueshmëria e kapitalit	28.50%	30.10% <sup>9</sup>
Kapitali aksioner (milionë lekë)	21,985.00	23,193.40
Rezultati neto (milionë lekë)	4,455.00	2,038.90
Kredia e re (milionë lekë)	92,600.00	48,733.00
Kredia me probleme neto / kredia neto	1.80%	1.10%
Kredia me probleme, bruto / totali i bilancit	0.60%	0.60%

<sup>9</sup> Në fundin e muajit mars 2004.

Banka e Shqipërisë nuk konstaton ndonjë element, i cili përfaqëson kërcënim për ecurinë e qëndrueshme të sistemit bankar edhe në të ardhmen. Megjithatë, si edhe më parë, Banka e Shqipërisë dëshiron ta shfrytëzojë këtë mundësi ligjore për të tërhequr vëmendjen rreth disa zhvillimeve, të cilat nëse nuk adresohen për zgjidhje në kohën dhe me vëmendjen e duhur, mund të shndërrohen në shqetësime të sistemit bankar dhe të pengojnë progresin e tij në drejtime të caktuara. Më konkretisht:

- Bankat duhet të forcojnë sistemet e tyre të identifikimit dhe të administrimit të rrezikut, në një kohë kur konkurrenca në treg është në rritje. Theksi duhet vendosur në përshtatjen e praktikave të nevojshme për monitorimin e veprimtarive kryesore dhe delikate të bankave që lidhen kryesisht me sistemet e teknologjise së informacionit dhe të komunikimit, veprimtarinë e këmbimit valutor dhe të investimit të fondeve etj.. Një vëmendje e vecantë i duhet kushtuar veprimtarisë së kreditimit, ku ka nevojë për përmirësimin dhe plotësimin e procedurave, për identifikimin dhe zhvillimin e mënyrave që lejojnë shkëmbimin e informacionit midis bankave mbi huamarrësit dhe cilësinë e tyre etj.. Strukturat drejtuese të bankës, duke përfshirë Këshillin Drejtues, Komitetin e Kontrollit dhe drejtuesit ekzekutivë, kanë përgjegjësinë kryesore për të mundësuar këto zhvillime.
- Me privatizimin e plotë të sistemit bankar, është e kuptueshme që janë elementet e ekonomisë së tregut ato që do të përcaktojnë ecurinë e sistemit bankar dhe të operatorëve të tij. Por vetë bankat si edhe strukturat e tjera administrative që mbikëqyrin tregun bankar dhe atë financiar, duhet të përqendrojnë vëmendjen e tyre drejt vendosjes dhe drejt zbatimit të një kuadri ligjor dhe rregullativ, i cili të sigurojë kushte të barabarta konkurrence midis operatorëve të tregut në drejtimet respektive. Një instrument i cili ndikon drejtpërsëdrejti në zbatimin e plotë të kuadrit rregullativ në këtë drejtim, është vendosja e një komunikimi të qëndrueshëm midis vetë institucioneve mbikëqyrëse të tregut financiar si edhe midis këtyre institucioneve mbikëqyrëse dhe operatorëve të këtij tregu.
- Bankat duhet t'i kushtojnë vëmendje në rritje, veprimtarisë së tyre në valutë të huaj. Këtu kemi parasysh kryesisht aktivitetin kreditues dhe atë të këmbimeve e të investimeve, por shtojmë edhe nevojën për ruajtjen e vlerës së kapitalit të bankave. I gjithë ky aktivitet është i ndjeshëm ndaj ecurisë së kursit të këmbimit, i cili në vitet e fundit ka evidentuar një mbiçmim të qëndrueshëm të njësisë monetare kombëtare. Për shkak të kohës së konsiderueshme gjatë së cilës është zhvilluar ky fenomen, bankat kanë mundur të përshtasin pozicionet e tyre duke siguruar një zhvillim normal të aktivitetit në këtë drejtim. Megjithatë, kjo ecuri e qetë për një kohë të konsiderueshme në të kaluarën, mund të krijojë idenë e vazhdimësisë së saj për një periudhë të pacaktuar në të ardhmen. E gjithë



kjo, do të varej nga ekzistenca e faktorëve që kanë ndikuar në ecurinë e kursit të këmbimit në vitet e fundit si edhe nga masa e ndikimit të tyre. Pa dashur të analizojmë faktorët që kanë ndikuar në këtë ecuri, ne besojmë që masa e ndikimit të disave prej faktorëve ka filluar të zbehet. Për këtë arsye, por duke u nisur mbi të gjitha nga nevoja për të qenë vazhdimisht vigjilent ndaj zhvillimeve të pafavorshme, tërheqim vëmendjen e bankave që të fillojnë të testojnë aktivitetin e tyre për zhvillime të tilla të mundshme. Ky proces duhet të fillojë me ndërtimin e skenareve të pafavorshem dhe me vlerësimin e ndikimit të tyre në rezultatin financiar të bankës. Banka e Shqipërisë, do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë këtij elementi në procesin e saj mbikëqyrës.

- Ne besojmë se sistemi bankar mund të luajë një rol edhe më aktiv në qëllimin e përbashkët për reduktimin e transaksioneve në *cash* dhe reduktimin e ekonomisë informale. Zgjerimi i aktivitetit bankar dhe afrimi i tij i mëtejshëm pranë publikut si edhe prezantimi i produkteve të reja që nxisin format e reja të pagesës dhe ofrojnë komoditetin e dëshiruar, janë zhvillime të cilat Banka e Shqipërisë i inkurajon që të vazhdojnë. Ne besojmë se ky proces do të ishte më i suksesshëm nëse do të kishte një angazhim edhe më të madh, të të gjitha institucioneve përkatëse të shtetit.
- Banka e Shqipërisë vlerëson se duhen bërë përpjekje më të mëdha dhe të vazhdueshme lidhur me forcimin e funksionit mbikëqyrës edhe në segmente të tjera të tregut financiar, duke theksuar veprimtarinë e sigurimit. Ky është një zhvillim i nevojshëm, në kushtet kur prirja në të ardhmen mund të jetë drejt integritit të veprimtarive në tregun financiar me njëra-tjetrën. Rritja e bashkëpunimit mes institucioneve mbikëqyrëse dhe formalizimi i këtij bashkëpunimi, është një hap tjetër i cili duhet nxitur dhe duhet realizuar aktualisht.
- Banka e Shqipërisë mendon se ka ardhur koha që të rritet presioni për eliminimin e çdo forme të dukshme dhe të rëndësishme të informalitetit në ekonomi. Në këtë kuadër, duhet të adresohet edhe ekzistenca e tregut paralel të këmbimeve valutore, duke forcuar masat administrative për mbylljen e tij si edhe duke krijuar kushte për tërheqjen e tij në aktivitetin formal të tregut të këmbimeve. Ne besojmë se analiza kosto-përfitim e këtij veprimi, flet në favor të mbylljes së këtij tregu në kushtet e rritjes dhe të përmirësimit të kapaciteteve të veprimtarisë së këmbimeve valutore nga ana e pjesëmarrësve të tregut formal (banka dhe zyra këmbimi), si edhe të uljes së koston me të cilën ofrohet ky shërbim.

Së fundi, Banka e Shqipërisë shpreh besimin se sistemi bankar do të shënojë zhvillime, të cilat do të ndikojnë në konsolidimin e mëtejshëm dhe në rritjen e rolit të tij në ecurinë e ekonomisë në vend.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
Këshilli Mbikëqyrës**

**V E N D I M**

**Nr. 59, datë 28.07.2004**

**Për**

**“ Lirimim nga detyra të Drejtorit aktual dhe emërimin e Drejtorit të ri të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë “.**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi kërkesën e Drejtorit të Departamentit të Emisionit, në mbështetje të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “ Për Bankën e Shqipërisë “, neni 43, shkronja h,

**V E N D O S I :**

1. Lirimim e z.Zihni Djepaxhia, nga detyra e Drejtorit të Departamentit të Emisionit.
2. Emërimin e zj.Sonila Taçi në detyrën e Drejtores së Departamentit të Emisionit.
3. Marrëdhëniet e punës të zj.Sonila Taçi në detyrën e Drejtores së Departamentit të Emisionit, fillojnë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhëniëve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretari  
Ylli Memisha**

**Kryetari  
Shkëlqim Cani**

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 1, Janar 2004**

1. Vendim nr. 01, datë 28. 01. 2004. Për miratimin e “Raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2003”
2. Vendim nr.02, datë 28.01. 2004. Për “Miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare -AIPS”.
3. Vendim nr.03, datë 28.01.2004. Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të thesarit (ATM)” miratuar me vendimin nr. 75, datë 25.09. 2002.
4. Vendim nr.04, datë 28.01.2004. Për një ndryshim në rregulloren “Mbi funksionimin e shërbimit të sistemit SËIFT” miratuar me vendimin nr. 16, datë 01.03. 2000.
5. Vendim nr.05, datë 28.01. 2004. Për miratimin e një ndryshimi në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullore “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 2, Shkurt 2004**

1. Vendim nr. 06, datë 11.02. 2004. Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtari bankare, të “Bankës Popullore” Sh.a.
2. Vendim nr. 07, datë 11.02. 2004. Për “Përcaktimin e pagës bazë të punonjësve të Bankës së Shqipërisë”.

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 3, Shkurt 2004**

1. Vendim nr. 08, datë 25.02.2004. Për miratimin e “Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2004”
2. Vendim nr.09, datë 25.02.2004. Për miratimin e deklaratës të Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimet e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri”
3. Vendim nr. 10, datë 25.02.2004. Për miratimin e rregullore “Për parandalimin e pastrimit të parave”.

4. Vendim nr.11, datë 25.02.2004 Për miratimin e udhëzimit “Mbi procedurat e nxjerrjes së urdhërzhdëmtimeve në Bankën e Shqipërisë”.
5. Vendim nr. 12, datë 25. 02. 2004. “Për miratimin e bilancit dhe për përdorimin e fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003”.
6. Vendim nr.13, datë 25.02.2004. Për “Pezullimin dhe ndalimin e kryerjes së disa veprimtarive të përfshira në aneksin e licencës së Bankës Italo-Shqiptare”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 4, Mars 2004**

1. Vendim nr. 16, datë 10.03.2004. Për “Miratimin e fondit numizmatik të monedhave metalike e të kartëmonedhave shqiptare”.
2. Vendim nr. 17, datë 10. 03. 2004. “Për miratimin e disa ndryshimeve në Sistemin Raportues të Unifikuar”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 5, Mars 2004**

1. Vendim nr. 20, datë 24.03.2004. Për miratimin e rregullores “Mbi kredinë brenda ditës”.
2. Vendim nr.21, datë 24.03.2004. “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin “Për kapitalin rregullator të bankës” miratuar me vendimin nr. 57, datë 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr. 40, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.
3. Vendim nr.22, datë 24.03.2004. Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”.
4. Vendim nr.23, datë 24.03.2004. Për “Lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”.

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 6, Mars 2004**

1. Vendim nr. 26, datë 14. 04. 2004. Për lejimin e ushtrimit të aktivitetit kredihënës nga Banka e Kursimeve

2. Vendim nr. 27 datë 14. 04. 2004. "Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 7, Prill 2004**

1. Vendim nr. 28, datë 28 04. 2004. Për "Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes".
2. Vendim nr. 29, datë 28 04. 2004. Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi kredinë njëditore"
3. Vendim nr. 30, datë 28. 04. 2004. Për dokumentin e "Politikës Operative të Mbikëqyrjes".
4. Vendim nr. 31, datë .28 04. 2004. Për "Emërimin e Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë"

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 8, Maj 2004**

1. Vendim nr. 35, datë 12 05. 2004. Për "Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të të riblerjes".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 9, Maj 2004**

1. Vendim nr. 36, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e Raportit "Vlerësimi i ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2004".
2. Vendim nr. 37, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare tek grupi financiar ICB HOLDING AG.
3. Vendim nr. 38, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e rregullores "Për adiministrimin e aktveve të qëndrueshme në Bankën e Shqipërisë".
4. Vendim nr. 39, datë 26. 05. 2004. Për miratimin e rregullores "Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 10, Qershor 2004**

1. Vendim nr. 46, datë 09. 06. 2004. Për "Politikën e përdorimit të internetit dhe e-mail".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 11, Korrik 2004**

1. Vendim nr, 47, datë 18.6.2004. Për "Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin maj të vitit 2004".
2. Vendim nr. 48, datë 18.6.2004. "Për disa ndryshime në rregulloren për prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 12, Korrik 2004**

1. Vendim nr, 50, datë 23. 06. 2004. "Disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.109, datë 24.12.2003 "Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë".
2. Vendim nr. 51, datë 23. 06. 2004. Për "Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes".

#### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 13, Korrik 2004**

1. Vendim nr, 52, datë 14.07. 2004. Për "Administrimin e rrezikut të kredisë"
2. Vendim nr. 53, datë 14.07. 2004. Për "Shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, në vitin 2005".